



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 146

Tiranë – E premte, 5 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 73/2016, datë 14.7.2016	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar..... 11425
Ligj nr. 74/2016, datë 14.7.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”..... 11425
Ligj nr. 75/2016, datë 14.7.2016	Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike..... 11431
Ligj nr. 78/2016, datë 25.7.2016	Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët “Albanian Lion 2016”..... 11444
Ligj nr. 79/2016, datë 25.7.2016	Për miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe ACR Holding, s.r.l., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Minierës së Kromit, Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit, Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit, Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit, Burrel..... 11445
Ligj nr. 80/2016, datë 25.7.2016	Për miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe ACR Holding, s.r.l., si koncesionari, për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Uzinës së Ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Përrenjasit e Pojskës..... 11454
Ligj nr. 81/2016, datë 25.7.2016	Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme..... 11459
Ligj nr. 83/2016, datë 25.7.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malaries..... 11460



LIGJ
Nr. 73/2016

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
LIGJIN NR. 9232, DATË 13.5.2004,
“PËR PROGRAMET SOCIALE TË
STREHIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 39/1 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) Në pikën 5 hiqet togfjalëshi “Ujëmbledhësi i Bovillës”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Për objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, kalimi i së drejtës së pronësisë mbi objektin dhe truallin realizohet pa pagesë nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, procedurat dhe afatet që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9708, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 74/2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 108/2013
“PËR TË HUAJT”¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt” bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 dhe kudo ku është përdorur në ligj, termi “largim me forcë” zëvendësohet me fjalën “largim”;

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Punëtor stinor” është i huaji, i cili e ka vendbanimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por, përkohësisht, qëndron ligjërisht në territorin e saj, për të kryer një aktivitet të punës stinore, në bazë të një ose më shumë kontratave të punës, me kohë të përcaktuar, të lidhura ndërmjet të huajt dhe punëdhënësit, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

¹ Ky ligj është i përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes”, numri CELEX 32014L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 27.5.2014, faqe 1–22.
Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal”, Numri CELEX 32014L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 375–390.

Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”, Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 155, datë 18.6.2009, faqe 17–29.

Direktivën 96/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetori 1996, “Në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve”, Numri CELEX 31996L0071, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 18, datë 21.1.1997, faqe 1–6.



3. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. “Personeli kyç” janë të huajt, sipas kategorie të mëposhtme:

a) “vizitorë biznesi” janë personat fizikë, të cilët punojnë në një pozicion drejtues brenda një personi juridik dhe janë përgjegjës për ngritjen e një aktiviteti tregtar. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që ndodhet brenda palës pritëse;

b) “të transferuar brenda ndërmarrjes/shoqërisë” janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kanë qenë ortakë të tij për gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të ndërmarrjes/shoqërisë (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas këtyre nënkategorive:

i) “menaxher” nënkupton një person, i cili mban një pozicion të lartë dhe drejton menaxhimin e subjektit pritës, merr mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionarëve të biznesit. Ky pozicion përfshin: drejtimin e subjektit pritës, të një departamenti ose nënndarjeje të tij; mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë, specialistëve apo menaxherëve; autoritetin për të rekomanduar punësimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;

ii) “specialist” nënkupton një person, i cili punon për grupin e ndërmarrjeve/shoqërive, zotëron njohuri të specializuara, thelbësore për fushat e aktivitetit të njësisë pritëse, teknikave apo menaxhimit. Në vlerësimin e njohurive të tilla duhet të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për njësinë pritëse, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, duke përfshirë përvojën e duhur profesionale, referuar një lloji pune ose aktiviteti që kërkon njohuri të veçanta teknike, duke përfshirë edhe mundësinë e pasjes së një profesioni të njohur;

iii) “praktikantët e diplomuar” janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të paktën 3 muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim, zotërojnë një diplomë universitare dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të tij në territorin e Republikës së

Shqipërisë, për qëllime të zhvillimit të karrierës apo për t’u trajnuar në metodat/teknikat e biznesit dhe të cilët paguhen gjatë periudhës së transferimit.”

4. Pas pikës 32 shtohen pikat 33, 34, 35, 36, 37 e 38 me këtë përmbajtje:

“33. “Ofrues shërbimesh biznesi” janë personat fizikë, përfaqësues të një ofruesi shërbimesh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim negocimin e shitjes së shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve, për llogari të ofruesit të shërbimeve. Ata nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

34. “Ofrues shërbimesh kontraktuale” janë personat fizikë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë për të ofruar shërbime me një konsumator në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kërkon praninë e punonjësve të tij, në një degë të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të përmbushë kontratën e ofrimit të shërbimeve.

35. “Profesionistë të pavarur” janë personat fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi, të cilët janë të regjistruar si të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kanë një kontratë, për ofrimin e shërbimeve, me një përfitues në Republikën e Shqipërisë.

36. “Person me statusin e mbrojtjes plotësuese” ka kuptimin sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

37. “Mbrojtja e përkohshme” i jepet të huajt, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë.

38. “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët “struktura që mbulon çështjet e shtetësisë dhe refugjatët” zëvendësohen me fjalët “autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.



2. Në pikën 5, pas fjalëve “zyrat konsullore jashtë vendit” shtohen fjalët “zyrat konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, si dhe agjentë të tjerë të kontraktuar në shtete të huaja”.

Neni 3

Në nenin 10, pika 1, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Fjalët “në nenin 8, të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “në nenin 6, të këtij ligji”.

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) përdor në hyrje një dokument të një personi tjetër ose dokument/vizë të falsifikuar apo një dokument të paautorizuar për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 4

Në nenin 15, pika 2, pas fjalëve “që ka lëshuar atë”, shtohen fjalët “ose shtetas të huaj me leje qëndrimi në atë shtet”.

Neni 5

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) i revokohet statusi i refugjatit dhe/ose është subjekt i largimit/dëbimit nga territori i Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Lëshimi i lejes së kalimit për të huajt, të cilët do të kthehen në vendin ku pranohen, në vendin e rezidencës apo të origjinës, bëhet nga autoritetet rajonale për kufirin dhe migracionin në juridiksionin territorial ku i huaji ka pasur së fundmi vendqëndrimin e tij dhe nga autoritetet konsullore të Republikës së Shqipërisë, kur i huaji ndodhet jashtë shtetit.”.

Neni 6

Në nenin 22, pika 3, pas fjalëve “mbajtësit e vizave të tipit “D/H”, lëshuar për motive humanitare”, shtohen fjalët “dhe të tipit “D/DS”, lëshuar për motiv shërbimi”.

Neni 7

Në nenin 24, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Në rast se nuk ka përfaqësi diplomatike/konsullore shqiptare në shtetin e aplikuesit ose në

vendin ku ai është banor, i huaji bën kërkesë me postë në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e parashikuar, sipas një liste të miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme, e cila publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Paraqitja personalisht për marrjen e vizës nga i huaji bëhet sipas pikës 4 të këtij neni.”.

Neni 8

Në nenin 25, pika 2, fjalët “të nenit 21” zëvendësohen me fjalët “të nenit 23”.

Neni 9

Në nenin 27, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin zgjat afatin e qëndrimit të përcaktuar në vizën e lëshuar apo afatin e lejuar të qëndrimit pa vizë, nëse i huaji kërkon zgjatjen e qëndrimit para përfundimit të afatit të vlefshëm të qëndrimit, vetëm për motive që vlerësohen të një rëndësie të veçantë, të një force madhore ose humanitare, kur nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë para përfundimit të afatit të lejuar.”.

Neni 10

Në nenin 30, pika 2, pas fjalëve “90 ditë brenda 180 ditëve nga hyrja”, hiqet fjala “e parë”.

Neni 11

Në nenin 33, pika 1, shkronja “a”, hiqen fjalët “jo e ripërtëritshme”.

Neni 12

Në nenin 35 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “c”, pas fjalës “i huaji” hiqet fjala “është” dhe shtohen fjalët “përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “mund të”, shtohen fjalët “lëshohet ose”.

Neni 13

Në nenin 36, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kundër urdhrorit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.



2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.”

Neni 14

Në nenin 38, pika 1, fjalët “jo më vonë se” zëvendësohen me fjalën “brenda”.

Neni 15

Në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, fjala “së paku” zëvendësohet me fjalët “deri në”.

Neni 16

Në nenin 42, pika 5, shkronja “a”, fjala “së paku” zëvendësohet me fjalët “deri në”.

Neni 17

Në nenin 53, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rast se i huaji del nga territori. Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet, kur:

- a) vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;
- b) vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;
- c) është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.”

Neni 18

Në nenin 65, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pajiset me leje të përhershme qëndrimi i huaji, familjarët e tij dhe personeli i tij kyç, i cili ka kryer një investim në Republikën e Shqipërisë, në sektorë strategjikë, në vlerën jo më pak se 2 milionë euro dhe dokumenton se ka krijuar mbi 100 vende pune, minimalisht për një periudhë 1-vjeçare.”

Neni 19

Në nenin 70, pika 1, hiqen fjalët “si dhe banori i përkohshëm”.

Neni 20

Në nenin 73 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) ofrues shërbimesh biznesi, të cilët nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;”

2. Në pikën 3, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) përfaqësuesit dhe stafi i organizatave jofitim-prurëse, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk shpërblehen për punën e tyre;”

3. Në pikën 3, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) përfaqësuesit dhe stafi i bashkësive fetare, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët kryejnë aktivitete të lidhura ekskluzivisht me shërbimin fetar apo bamirës dhe nuk shpërblehen për punën e tyre.”

Neni 21

Në nenin 80, pika 1, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) kur i huaji ndërpret kontratën e punës, për arsye të ndryshme, dhe largohet nga vendi i punës për të cilin ka marrë lejen.

Në këtë rast, punëdhënësi informon, brenda 2 javëve, autoritetet përgjegjëse ku i huaji është pajisur me lejen e punës dhe atë të qëndrimit.”

Neni 22

Në nenin 84 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas fjalës “paraardhës” shtohen fjalët “kur subjekti ka aktivitet në vazhdimësi dhe 10 për qind të totalit të të punësuarve në momentin e aplikimit, për subjektet e hapura rishitas”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti shtetëror përgjegjës për punësim, përpara miratimit të kërkesës së të huajit për plotësimin e një vendi të lirë pune, propozon, brenda afatit kohor të publikimit të vendit të lirë të punës, kandidatë të përshtatshëm, sipas profilit të kërkuar, të gatshëm të punojnë në vendin vakant të punës, si më poshtë:”



Neni 23

Në nenin 87, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur i huaji nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës, për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “A/P”, me afat njëvjeçar, e ripërtëritshme dy herë radhazi me afat dyvjeçar.”.

Neni 24

Në nenin 88 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 hiqen fjalët “dhe që të rikthehet në vendin e origjinës pas përfundimit të kontratës së punës”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rast se kontrata/oferta e punës e të huajit përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huaji duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara.”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pas përfundimit të kontratës së punës, i huaji duhet të rikthehet në vendin e tij të origjinës, me përjashtim të rasteve kur plotëson kriteret, sipas legjislacionit në fuqi, për t’u pajisur me leje qëndrimi.”.

Neni 25

Në nenin 89 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të huajt, të cilët transferohen nga një ndërmarrje/shoqëri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një degë të saj (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të kenë qenë të punësuar për këtë ndërmarrje/shoqëri, për një periudhë:

a) gjashtëmujore të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim, për kategoritë:

i) administrator;

ii) specialistë.

b) tremujore të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim, për kategorinë “praktikantë të diplomuar.”.

2. Në pikën 2, shkronja “c”, fjala “kompani” zëvendësohet me fjalët “ndërmarrje/shoqëri” dhe shkronja “ç” shfuqizohet.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Në pikën 7, fjalët “personel kryesor” zëvendësohen me fjalën “administratorë”.

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Periudha fillestare e vlefshmërisë së lejes së punës për të transferuarit brenda ndërmarrjes/shoqërisë, të cilët bëjnë pjesë në kategoritë administratorë apo specialistë, është e barabartë me kohëzgjatjen e kërkuar për kryerjen e punës së përcaktuar, duke filluar nga koha e transferimit të tij deri në një periudhë maksimale të vlefshmërisë prej pesë vjetësh.”.

Neni 26

Në nenin 90, pika 1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) në rastin e “Praktikantëve të diplomuar”, punëdhënësi paraqet një marrëveshje trajnimi, e cila përmban programin e trajnimit, kohëzgjatjen e tij, si dhe kushtet në të cilat praktikanti do të mbikëqyret.”.

Neni 27

Në nenin 98 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, fjalët “së paku 2-vjeçare” zëvendësohen me fjalët “minimale 1 vit”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e punës e tipit “A/KL”, nëse plotësohen kriteret e kërkuara, jepet për herë të parë me një afat jo më pak se 1 vit, ripërtërihet më pas dy herë të tjera me një afat 2-vjeçar dhe më pas me afat të përhershëm.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur i huaji nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës, për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “A/KL”, me afat 1-vjeçar, e ripërtëritshme dy herë radhazi me afat 2-vjeçar.”.

Neni 28

Në nenin 100 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjala “trevjeçar” zëvendësohet me fjalën “dyvjeçar”.



2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Leja e punës për investitorin e huaj është e ripërtëritshme me afat kohor trevjeçar, nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është dhënë leja e mëparshme, fillestare, e punës.

1/2. Leja e punës është e përhershme, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së lejes së dytë me afat trevjeçar, nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës.

1/3. Në rastet kur investitori i huaj nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “B/P”, me afat dyvjeçar, e ripërtëritshme me afat trevjeçar.”.

Neni 29

Në nenin 101 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “b”, nënparagrafët “iv” dhe “v”, ndryshohen si më poshtë:

“iv) punonjës në bazë kontratash, të cilët shpërblehen për punën e tyre në një organizatë të huaj, të regjistruar si një organizatë jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;

v) përfaqësues dhe anëtarë të bordit drejtues të organizatave jofitimprurëse, të njohura dhe të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilët punojnë në bazë kontratash dhe shpërblehen për punën e tyre.”.

2. Në shkronjën “b”, pas nënparagrafit “vii” shtohet nënparagrafi “viii” me këtë përmbajtje:

“viii) vizitorë biznesi me qëndrim të përkohshëm.”.

3. Shkronjat “c” dhe “ç” ndryshohen si më poshtë:

“c) ofrues të shërbimeve të biznesit, të cilët nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) refugjati, i huaji në mbrojtje të përkohshme dhe personi me statusin e mbrojtjes plotësuese, në përputhje me ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 30

Në nenin 102, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ofruesit e shërbimeve kontraktuese, të cilëve u lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t’u nënshtrohen këtyre kushteve:

a) duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së shkëputjes duhet të ekzistojë një marrëdhënie pune ndër-mjet punonjësit dhe personit juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

b) duhet të kenë të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e veçantë, objekt i kontratës së shërbimit;

c) personat fizikë, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës ku shërbimi ofrohet, duhet të kenë kualifikimet profesionale përkatëse, kur kjo gjë është e nevojshme;

ç) personat fizikë nuk do të marrin shpërblim për ofrimin e shërbimeve të tjera, përveç shpërblimit të dhënë nga klienti, me të cilin punëdhënësi i tij/i saj ka një kontratë për ofrimin e shërbimit;

d) hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të jetë për një periudhë të përgjithshme jo më shumë se dymbëdhjetë muaj ose në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës, gjithmonë kur qëndrimi nuk e kalon periudhën dymbëdhjetëmujore;

dh) numri i personave të mbuluar nga kontrata e shërbimit nuk mund të jetë më i madh sesa është e nevojshme për të përmbushur kontratën. Ky numër mund të përcaktohet nga ligjet, rregulloret dhe kërkesat e palës ku shërbimi do të ofrohet.

2/2. “Profesionistët e pavarur”, të cilëve u lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t’u nënshtrohen këtyre kushteve:

a) duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, kur ata janë të regjistruar si persona të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, duhet të kenë një kontratë shërbimi për një periudhë që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj;

b) personat fizikë, që hyjnë për ofrimin e shërbimit, duhet të zotërojnë, së paku, tre vjet përvojë profesionale në fushën e aktivitetit që është objekt i kontratës;



c) personat fizikë, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë për ofrimin e një shërbimi kontraktual, duhet të kenë kualifikime profesionale, kur kjo është e nevojshme, për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës që e merr këtë shërbim.

2/3. Hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i profesionistëve të pavarur në shërbim të palës së interesuar do të jetë për një periudhë të përgjithshme jo më shumë se dymbëdhjetë muaj ose për kohëzgjatjen e kontratës, cilado qoftë ajo, por, gjithmonë, kur qëndrimi nuk e kalon periudhën dymbëdhjetëmujore.”

Neni 31

Në nenin 105, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Përfshihen nga tarifa shtetërore për pajisjen me leje qëndrimi shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e përkatësive etnike shqiptare të republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi.”

Neni 32

Në nenin 119 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. I huaji ka të drejtë të ankimojë urdhrin e qëndrimit në një territor të caktuar në gjykatën kompetente për çështjet administrative.”

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Fondet për qëndrimin në një territor të caktuar mbulohen nga buxheti i ministrisë së Punëve të Brendshme. Mënyra e administrimit të fondeve dhe qëndrimit në një territor të caktuar përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 33

Në nenin 141 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Profili vjetor i migracionit miratohet me urdhr të ministrit, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.”

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Profili i zgjeruar i migracionit përgatitet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për

menaxhimin e të dhënave statistikore për migracionin një herë në katër vjet, brenda 9-mujorit të vitit pasardhës, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 34

Në nenin 145, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) Dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 30 000 lekë i huaji, i cili:

i) gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë pa dokumentin e kërkuar të udhëtimit, vizën apo lejen e qëndrimit apo nuk përmbush detyrimin për t’u regjistruar apo për të aplikuar për leje qëndrimi;

ii) punësohet me pagesë ose praktikon një zana, pa të drejtë për punësim fitimprurës;

iii) nuk përmbush, nëse i kërkohet, detyrimin për të raportuar ose kërkesën për t’u paraqitur para autoriteteve për të dhënë informacion.”

Neni 35

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 32, dhe të pikës 2, të nenit 33, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri i Punëve të Jashtme që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9709, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 75/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARISIT, NË KUADËR TË KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, bërë në Paris më 12.12.2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9710, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJA E PARISIT

Palët e kësaj Marrëveshjeje,

duke qenë Palë të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, më poshtë e referuar si “Konventa”;

në zbatim të Platformës Durban për Veprim të Përmirësuar, të krijuar nga vendimi 1/CP.17 të Konferencës së Palëve për Konventën në sesionin e saj të shtatëmbëdhjetë;

në ndjekje të objektivit të Konventës dhe e udhëhequr nga parimet e saj, duke përfshirë parimin e barazisë dhe përgjegjësitë e përbashkëta, por përgjegjësitë/kapacitetet e diferencuara përkatëse në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare;

duke njohur nevojën për një reagim efektiv dhe progresiv ndaj kërcënimit urgjent të ndryshimit të klimës në bazë të njohurive shkencore më të mira të disponueshme;

duke njohur, gjithashtu, nevojat specifike dhe rrethanat e veçanta të Palëve, të cilat janë vende në zhvillim, veçanërisht ato që janë vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës, siç parashikohet në Konventë;

duke marrë në konsideratë të plotë nevojat specifike dhe situatat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara në lidhje me financimin dhe transferimin e teknologjisë;

duke pranuar që Palët mund të ndikohen jo vetëm nga ndryshimi i klimës, por, gjithashtu, nga ndikimet e masave të marra në reagim të saj;

duke theksuar marrëdhënien e brendshme që veprimet, reagimet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës kanë me aksesin e drejtë ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe çrrënjosjen e varfërisë;

duke njohur prioritetin thelbësor të ruajtjes së sigurisë ushqimore dhe për t'i dhënë fund urisë, dhe vulnerabilitetet e veçanta të sistemeve të prodhimit të ushqimit ndaj ndikimeve negative të ndryshimit të klimës;

duke marrë parasysh kërkesat e një tranzicioni të drejtë të krahut/forcës të/së punës dhe krijimit të një pune të denjë dhe profesioneve cilësore në përputhje me prioritetet e zhvillimit të përçaktuara në nivel kombëtar;

duke pranuar se ndryshimi i klimës është një shqetësim i përbashkët i njerëzimit, Palët, kur marrin masa për të trajtuar ndryshimin e klimës, duhet të respektojnë, promovojnë dhe të marrin në konsideratë detyrimet e tyre përkatëse për të drejtat e njeriut, të drejtën për shëndet, të drejtat e popullatave indigjene, komunitetet lokale, emigrantët, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat në situata vulnerabël dhe të drejtën për zhvillim, si edhe barazinë gjinore, fuqizimin e gruas dhe barazinë e brezave;

duke njohur rëndësinë e konservimit dhe të përmirësimit, si të jetë e përshtatshme, të vaskave dhe rezervuarëve të gazeve serrë të referuara në Konventë;

duke vënë në dukje rëndësinë e sigurimit të integritetit të të gjitha ekosistemeve, përfshirë oqeanet dhe mbrojtjen e biodiversitetit, të njohura nga disa kultura, si Nëna Tokë dhe duke theksuar rëndësinë për disa, të konceptit “drejtësia e klimës”, kur merren masa për të trajtuar ndryshimin e klimës;

duke afirmuar rëndësinë e arsimit/edukimit, trajnimit, ndërgjegjësimit të publikut, pjesëmarrjes së publikut, aksesin e publikut në informacion dhe bashkëpunimin në të gjitha nivelet mbi çështjet e trajtuara në këtë Marrëveshje;

duke njohur rëndësinë e angazhimeve të të gjitha niveleve të grupeve qeveritare dhe të ndryshme të interesit, në përputhje me legjislacionet kombëtare përkatëse të Palëve, në trajtimin e ndryshimit të klimës;

duke pranuar, gjithashtu, që mënyra e jetesës e qëndrueshme dhe modelet e qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, me Palët të cilat janë



vende të zhvilluara që marrin drejtimin, luajnë rol të rëndësishëm në trajtimin e ndryshimit të klimës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet që përmbahen në nenin 1 të Konventës. Për më tepër:

1. “Konventa” nënkupton Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, të miratuar në Nju-Jork, më 9 maj 1992.

2. “Konferenca e Palëve” nënkupton Konferencën e Palëve të Konventës.

3. “Palë” nënkupton një Palë në këtë Marrëveshje.

Neni 2

1. Kjo Marrëveshje, në përmirësimin e zbatimit të Konventës, duke përfshirë objektivat, qëllimet e saj për të forcuar reagimin global ndaj kërcënimit të ndryshimit të klimës, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të çrrënjësuar varfërinë, përfshirë, duke:

a) ruajtur rritjen në temperaturën mesatare globale nën 2°C mbi nivelet paraindustriale dhe për të vazhduar përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës deri në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale, duke pranuar se kjo do të reduktoje ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës;

b) rritur aftësinë/mundësinë për t’u përshtatur ndaj ndikimeve negative të ndryshimit të klimës dhe për të nxitur aftësitë rikuperuese të klimës dhe zhvillimin e emetimeve të ulëta të emetimeve të gazit serrë, në një mënyrë që nuk rrezikon prodhimin e ushqimit;

c) realizuar flukset financiare në përputhje me një rrugë drejt emetimeve të ulëta të gazit serrë dhe zhvillimit me aftësi rikuperuese ndaj klimës;

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të reflektuar barazi dhe parimin e përgjegjësisë të përbashkëta, por përgjegjësi dhe kapacitete të diferencuara përkatëse, në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

Neni 3

Si kontribute të përcaktuara kombëtare, si reagim global ndaj ndryshimit të klimës, të gjitha Palët do të ndërmarrin dhe do të komunikojnë

përpjekje ambicioze, siç janë përcaktuar në nenet 4, 7, 9, 10, 11 dhe 13, me qëllim të arritjes së qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, siç është përcaktuar në nenin 2. Përpjekjet e të gjitha Palëve do të përfaqësojnë një progres me kalimin e kohës, ndërsa pranojnë nevojën për të mbështetur Palët të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin efektiv të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

1. Në mënyrë që të arrihet qëllimi afatgjatë i temperaturës i përcaktuar në nenin 2, Palët synojnë të arrijnë pikun global të emetimeve të gazit serrë, sa më shpejt që të jetë e mundur, duke pranuar që arritja e pikut do të marrë më shumë kohë për Palët që janë vende në zhvillim dhe për të ndërmarrë reduktime të shpejta më pas, në përputhje me shkencën më të mirë të disponueshme, në mënyrë që të arrihet një ekuilibër ndërmjet emetimeve antropogjene nga burime dhe heqjet nga vaskat e gazeve serrë në gjysmën e dytë të shekullit, në bazë të barazisë dhe në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të çrrënjësuar varfërinë.

2. Secila Palë do të përgatisë, do të komunicojë dhe do të ruajë kontribute të njëpasnjëshme të përcaktuara në nivel kombëtar që ajo synon të arrijë. Palët do të ndjekin masat zbutëse vendase, me qëllim të arritjes së objektivave të këtyre kontributeve.

3. Kontributet e njëpasnjëshme të përcaktuara në nivel kombëtar, të secilës Palë, do të përfaqësojnë një progres përtej kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar që zhvillohen aktualisht dhe reflektojnë ambicien e saj më të lartë të mundshme, duke reflektuar përgjegjësitë e saj të përbashkëta por të diferencuara dhe aftësitë/mundësitë përkatëse, në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

4. Palët që janë vende të zhvilluara duhet të vazhdojnë të marrin drejtimin duke ndërmarrë synime reduktimi të emetimeve absolute për ekonominë e gjerë. Palët që janë vende në zhvillim duhet të vazhdojnë të rrisin përpjekjet e tyre për zbutje dhe inkurajohen të zhvendosen me kalimin e kohës drejt reduktimeve të emetimeve për ekonominë e gjerë ose synime kufizimi në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

5. Do të sigurohet mbështetje për Palët, të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin e këtij



neni, në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11, duke pranuar që mbështetja më e madhe për Palët të cilat janë vende në zhvillim, do të lejojë ambicie më të lartë në veprimet e tyre.

6. Vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), mund të përgatisin dhe komunikojnë strategjitë, planet dhe veprimet për zhvillimin e emetimeve të ulëta të gazit serrë, duke reflektuar rrethanat e tyre të veçanta.

7. Bashkëpërfitimet e zbutjes, që vijnë si rezultat nga veprimi i adaptimit dhe planeve të diversifikimit ekonomik të Palëve, mund të kontribuojnë në rezultate zbutjeje sipas këtij neni.

8. Në komunikimin e kontributeve të tyre kombëtare të përcaktuara, të gjitha Palët do të sigurojnë informacionin e nevojshëm për qartësi, transparencë dhe kuptim, në përputhje me vendimin 1/CP.21 dhe çdo vendim përkatës të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

9. Secila Palë do të komunikojë një kontribut të përcaktuar kombëtar, çdo pesë vjet, në përputhje me vendimin 1/CP.21 dhe çdo vendim përkatës të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe të informohen nga rezultatet e analizës globale të referuar në nenin 14.

10. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të marrë në konsideratë afatet kohore të përbashkëta për kontributet e përcaktuara kombëtare në sesionin e saj të parë.

11. Një Palë, në çdo kohë, mund të rregullojë kontributin e saj të përcaktuar kombëtar ekzistues, më qëllim të përmirësimit/rritjes të/së nivelit të saj të ambicies, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

12. Kontributet e përcaktuara kombëtare, të komunikuar nga Palët, do të regjistrohen në një regjistër publik që mbahet nga sekretariati.

13. Palët do të japin llogari për kontributin e tyre të përcaktuar në nivel kombëtar. Në dhënien e llogarisë për emetimet antropogjene dhe heqjet që korrespondojnë me kontributet e tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, Palët do të promovojnë integritet mjedisor, transparencë, saktësi, plotësi, krahasueshmëri dhe përputhshmëri dhe do të garantojnë shmangien e dublikimit të dhënies së llogarisë, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

14. Në kontekstin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, kur njohin dhe zbatojnë veprimet zbutëse në lidhje me emetimet antropogjene dhe heqjet, Palët duhet të marrin në konsideratë metodat ekzistuese dhe udhëzimin sipas Konventës, në bazë të dispozitave të paragrafit 12 të këtij neni.

15. Palët do të marrin në konsideratë, në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, shqetësimet e Palëve, me ekonomitë që janë prekur më shumë nga ndikimet e masave reaguese, veçanërisht Palët që janë vende në zhvillim.

16. Palët, duke përfshirë organizatat rajonale të integritimit ekonomik dhe shtetet e tyre anëtare, që kanë arritur një marrëveshje për të vepruar së bashku, sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të njoftojnë sekretariatit për termat e marrëveshjes, duke përfshirë nivelin e emetimit të alokuar për secilën Palë, brenda periudhave kohore përkatëse, kur komunikojnë kontributet e tyre të përcaktuara në nivel kombëtar. Sekretariati do të informojë më pas Palët dhe nënshkruesit e Konventës për termat/kushtet e asaj marrëveshjeje.

17. Secila palë e një marrëveshjeje të tillë do të jetë përgjegjëse për nivelet e saj të emetimit, siç është përcaktuar në marrëveshjen e referuar në paragrafin 16 më lart, në përputhje me paragrafët 13 dhe 14 të këtij neni dhe nenet 13 dhe 15.

18. Nëse Palët që veprojnë së bashku, veprojnë kështu në kuadër të dhe së bashku me një organizatë rajonale për integrim ekonomik e cila është Palë e kësaj Marrëveshjeje, secili shtet anëtar i asaj organizate individuale rajonale për integrim ekonomik dhe së bashku me organizatën rajonale për integrim ekonomik, do të jetë përgjegjëse për nivelin e saj të emetimit, siç është përcaktuar në marrëveshjen e komunikuar, sipas paragrafit 16 të këtij neni, në përputhje me paragrafët 13 dhe 14 të këtij neni dhe nenet 13 dhe 15.

19. Të gjitha Palët duhet të përpiqen të formulojnë dhe komunikojnë një strategji zhvillimi afatgjatë për emetime të ulëta të gazit serrë, duke iu referuar nenit 2, duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e tyre të përbashkëta, por të diferencuara dhe aftësitë/mundësitë



përkatëse në bazë të rrethanave të ndryshme kombëtare.

Neni 5

1. Palët duhet të marrin masa për të ruajtur dhe përmirësuar, si të jetë e përshtatshme, vaskat dhe rezervuarët e gazeve serrë, siç është referuar në nenin 4, paragrafi 1/d të Konventës, duke përfshirë pyjet.

2. Palët inkurajohen që të marrin masa për të zbatuar dhe mbështetur, duke përfshirë pagesat në bazë të rezultateve, kuadrin ekzistues, siç është përcaktuar në udhëzimin përkatës dhe vendimet mbi të cilat tashmë është rënë dakord sipas Konventës, për qasjet politike dhe stimujt pozitivë për aktivitetet në lidhje me reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve dhe roli i konservimit, menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe përmirësimi i stoqeve (rezervave) të karbonit të pyjeve në vendet në zhvillim; dhe qasje politikash alternative, të tilla si qasje zbutjeje dhe adaptimi të përbashkëta për menaxhimin integral dhe të qëndrueshëm të pyjeve, ndërkohë duke afirmuar rëndësinë e stimujve, si të jetë e përshtatshme, përfitime pa karbon që lidhen me këto lloj qasjesh.

Neni 6

1. Palët njohin që disa Palë zgjedhin të ndjekin bashkëpunim vullnetar në zbatimin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, për të lejuar për ambicie më të lartë në veprimet e tyre, për zbutje dhe adaptim dhe për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm dhe integritet mjedisor.

2. Palët, kur angazhohen mbi baza vullnetare në qasje bashkëpunuese, që përfshijnë përdorimin e rezultateve të zbutjes, në nivel ndërkombëtar, të transferuara drejt kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar, do të nxisin zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurojnë integritet mjedisor dhe transparencë, duke përfshirë në qeverisje dhe do të zbatohet llogaridhënie rigoroze për të garantuar, ndër të tjera, shmangien e dublikimit të llogaridhënies, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Përdorimi i rezultateve të zbutjes në nivel ndërkombëtar, të transferuara për të arritur

kontributet e përcaktuara në nivel kombëtar, sipas Marrëveshjes, do të jetë vullnetare dhe e autorizuar nga Palët pjesëmarrëse.

4. Një mekanizëm për të kontribuar në zbutjen e emetimeve të gazit serrë dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm, krijohet nëpërmjet kësaj, nën autoritetin dhe udhëzimin e Konferencës së Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, për përdorim nga Palët mbi baza vullnetare. Ai do të mbikëqyret nga një organ i emëruar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe do të synojë të:

a) promovojë zbutjen e emetimeve të gazit serrë ndërsa nxit zhvillimin e qëndrueshëm;

b) stimulojë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen në zbutjen e emetimeve të gazit serrë nga publiku dhe subjektet private të autorizuara nga një Palë;

c) kontribuojë në reduktimin e niveleve të emetimit në Palët pritëse, e cila do të përfitojë nga aktivitetet e zbutjes që rezultojnë në reduktimin e emetimeve që mund të përdoren, gjithashtu, nga një Palë tjetër, për të përmbushur kontributin e saj të përcaktuar në nivel kombëtar; dhe

d) shpërndajë një zbutje të përgjithshme në emetimet globale.

5. Reduktimet e emetimeve që rrjedhin nga mekanizmi i referuar në paragrafin 4 të këtij neni, nuk do të përdoren për të demonstruar arritje të kontributit të përcaktuar në nivel kombëtar te Palët pritëse, nëse përdoret nga një Palë tjetër për të demonstruar arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar.

6. Konferenca e Palëve, që shërben si takimi i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të garantojë që një pjesë e të ardhurave, nga aktivitetet nën mekanizimin e referuar në paragrafin 4 të këtij neni, përdoren për të mbuluar shpenzime administrative, si edhe për të asistuar Palët të cilat janë vende në zhvillim, që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës, për të përmbushur kostot e adaptimit.

7. Konferenca e Palëve, që shërben si takimi i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të miratojë rregullat, modalitete dhe procedurat për mekanizmin e referuar në paragrafin 4 të këtij neni në sesionin e saj të parë.

8. Palët njohin rëndësinë e qasjeve të integruara, holistike dhe të balancuara jotregtare



që janë të disponueshme për Palët, për të asistuar në zbatimin e kontributeve të tyre të përcaktuara në nivel kombëtar, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe çrrënjësjes së varfërisë, në një mënyrë të koordinuar dhe efektive, duke përfshirë ndër të tjera, zbutje, adaptim, financim, transferim teknologjie dhe ndërtim kapacitetsh, si të jetë e përshtatshme. Këto qasje do të synojnë të:

- a) promovojnë ambicien e zbutjes dhe adaptimit;
- b) rrisin pjesëmarrjen e publikut dhe të sektorit privat në zbatimin e kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar; dhe
- c) mundësojnë mundësitë për koordinimin përmes instrumenteve dhe planifikimeve perkatëse institucionale.

9. Nëpërmjet kësaj përcaktohet një kuadër për qasjet jotregtare për zhvillimin e qëndrueshëm, për të promovuar qasjet jotregtare të referuara në paragrafin 8 të këtij neni.

Neni 7

1. Palët nëpërmjet kësaj krijojnë qëllimin global për adaptimin për të përmirësuar kapacitetin adaptues, forcuar aftësitë rikuperuese dhe reduktuar vulnerabilitetin ndaj ndryshimit të klimës, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke siguruar një reagim adaptimi të përshtatshëm në kontekstin e qëllimit të temperaturës të referuar në nenin 2.

2. Palët pranojnë që adaptimi është një sfidë globale me të cilën përballen të gjithë me dimensione lokale, nënkombëtare, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe që është një komponent kryesor dhe sjell kontribut për reagim global afatgjatë ndaj ndryshimit të klimës për të mbrojtur njerëzit, jetesën dhe ekosistemet, duke marrë në konsideratë nevojat urgjente dhe të menjëhershme të atyre Palëve që janë vende në zhvillim, që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës.

3. Përpjekjet për adaptim të Palëve, të cilat janë vende në zhvillim, do të njihen në përputhje me modalitetet që do të miratohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si një takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit në sesionin e saj të parë.

4. Palët njohin që nevoja aktuale për adaptim është e rëndësishme dhe që nivele më të larta

zbutjeje, mund të reduktojnë nevojën për përpjekje shtesë adaptimi dhe që nevoja më të mëdha adaptimi mund të përfshijnë kosto më të larta adaptimi.

5. Palët pranojnë që veprimet për adaptim duhet të ndjekin një qasje të drejtuar nga shteti, të përgjegjshme ndaj gjinisë, pjesëmarrëse dhe plotësisht transparente, duke marrë në konsideratë grupet vulnerabël, komunitetet dhe ekosistemet dhe duhet të bazohet në dhe të drejtohet nga shkencë më e mirë e disponueshme dhe, si të jetë e përshtatshme, njohuri tradicionale, njohuri për popullatat indigjene dhe sistemet lokale të njohurive, me qëllim integrimin e adaptimit në politikat dhe veprimet perkatëse socio-ekonomike dhe mjedisore, kur është e përshtatshme.

6. Palët njohin rëndësinë e mbështetjes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mbi përpjekjet e adaptimit dhe rëndësinë e marrjes në konsideratë të nevojave të Palëve të cilat janë vende në zhvillim, veçanërisht ato që janë vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës.

7. Palët duhet të forcojnë bashkëpunimin e tyre në përmirësimin e veprimeve për adaptimin, duke marrë në konsideratë Kuadrin e Adaptimit të Kankunit, duke përfshirë në lidhje me:

a) ndarjen e informacionit, praktikat e mira, përvojat dhe mësimet e marra, duke përfshirë, si të jetë e përshtatshme, pasi këto lidhen me shkencën, planifikim, politikat dhe zbatimin në lidhje me veprimet e adaptimit;

b) forcimin e planifikimeve institucionale, duke përfshirë ato sipas Konventës që i shërben kësaj Marrëveshjeje, për të mbështetur sintezën e informacionit dhe njohurive perkatëse dhe ofrimin e mbështetjes teknike dhe udhëzim për Palët;

c) forcimin e njohurive shkencore për klimën, duke përfshirë kërkimet, vëzhgimet sistematike të sistemit të klimës dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, në një mënyrë që informon shërbimet klimatike dhe mbështet vendimmarrjen;

d) asistimin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për identifikimin e praktikave efektive të adaptimit, nevojat e adaptimit, prioritetet, mbështetjen e ofruar dhe të marrë për veprimet dhe përpjekjet e adaptimit dhe sfidat dhe boshllëqet në një mënyrë që është në përputhje me inkurajimin e praktikave të mira;



e) përmirësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë të veprimeve të adaptimit.

8. Organizatat dhe agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, inkurajohen që të mbështesin përpjekjet e Palëve për të zbatuar veprimet e referuara në paragrafin 7 të këtij neni, duke marrë në konsideratë dispozitat e paragrafit 5 të këtij neni.

9. Secila Palë, si të jetë e përshtatshme, do të angazhohet në proceset e planifikimit të adaptimit dhe të zbatimit të veprimeve, duke përfshirë zhvillimin apo përmirësimin e planeve, politikave dhe/ose kontributeve përkatëse, të cilat mund të përfshijnë:

a) zbatimin e veprimeve, sipërmarrjeve dhe/ose përpjekjeve adaptuese;

b) procesin për të formuluar dhe zbatuar plane kombëtare adaptimi;

c) vlerësimin e ndikimeve të ndryshimit të klimës dhe vulnerabilitet, me qëllim të formulimit të veprimeve prioritare të përcaktuara në nivel kombëtar, duke marrë në konsideratë personat, vendet dhe ekosistemet vulnerabël;

d) monitorimin dhe vlerësimin dhe duke mësuar nga planet, politikat, programet dhe veprimet e adaptimit; dhe

e) ndërtimin e aftësive rikuperuese të sistemeve social-ekonomike dhe ekologjike, duke përfshirë nëpërmjet diversifikimit ekonomik dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

10. Secila Palë, si të jetë e përshtatshme, duhet të dorëzojë dhe të përditësojë periodikisht një komunikim adaptimi, i cili mund të përfshijë prioritetet e saj, zbatimin dhe nevojat e mbështetjes, planet dhe veprimet, pa krijuar ndonjë ngarkesë shtesë për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

11. Komunikimi i adaptimit, i referuar në paragrafin 10 të këtij neni, si të jetë e përshtatshme, do të dorëzohet dhe do të përditësohet periodikisht, si një komponent i ose në lidhje me komunikimet ose dokumentet e tjera, duke përfshirë një plan adaptimi kombëtar, një kontribut të përcaktuar kombëtar, siç është referuar në nenin 4, paragrafi 2, dhe/ose një komunikim kombëtar.

12. Komunikimet e adaptimit, të referuara në paragrafin 10 të këtij neni do të regjistrohen në një regjistër publik që mbahet nga sekretariati.

13. Mbështetja e vazhdueshme dhe e përmirësuar ndërkombëtare do t'u ofrohet Palëve, të cilat janë vende në zhvillim për zbatimin e paragrafëve 7, 9, 10 dhe 11 të këtij neni, në përputhje me dispozitat e neneve 9, 10 dhe 11.

14. Analiza globale e referuar në nenin 14, ndër të tjera, do të:

a) njohë përpjekjet e adaptimit nga Palët të cilat janë vende në zhvillim;

b) rrisë zbatimin e veprimeve të adaptimit duke marrë në konsideratë komunikimin e adaptimit të referuar në paragrafin 10 të këtij neni;

c) Rishikojë mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e adaptimit dhe mbështetjen e ofruar për adaptim; dhe

d) Rishikojë progresin e përgjithshëm të bërë në arritjen e qëllimit global mbi adaptimin, e referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 8

1. Palët njohin rëndësinë e shmangies, minimizimit dhe trajtimit të humbjeve dhe dëmtimeve që shoqërohen me efektet negative të ndryshimit të klimës, duke përfshirë ngjarje ekstreme klimatike dhe ngjarje akute të ngadalta dhe rolin e zhvillimit të qëndrueshëm në reduktimin e rrezikut të humbjeve dhe dëmtimeve.

2. Mekanizmi Ndërkombëtar i Varshavës për Humbje dhe Dëmtime të lidhura me Ndikimet e Ndryshimit të Klimës, do të jetë subjekt i autoritetit dhe udhëzimit të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit dhe mund të përmirësohet dhe forcohet, siç është përcaktuar nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Palët duhet të rrisin të kuptuarin, veprimin dhe mbështetjen, duke përfshirë nëpërmjet Mekanizmit Ndërkombëtar të Varshavës, si të jetë e përshtatshme, mbi baza bashkëpunuese dhe lehtësuese në lidhje me humbjet dhe dëmtimet që lidhen me efektet negative të ndryshimit të klimës.

4. Në përputhje me rrethanat, fushat e bashkëpunimit dhe lehtësimit për të përmirësuar kuptimin, veprimin dhe mbështetjen mund të përfshijnë:

a) sistemet e paralajmërimit para kohe;

b) gatishmëria në raste emergjencash;

c) ngjarje akute të ngadalta;



d) ngjarje që mund të përfshijnë humbje dhe dëmtime të pakthyeshme dhe të përhershme;

e) vlerësim dhe menaxhim rreziku gjithëpërfshirës;

f) shërbime të sigurimit të riskut, bashkimi i rreziqeve klimatike dhe zgjidhje të tjera sigurimi;

g) humbje joekonomike;

h) aftësi rikuperuese të komuniteteve, jetesës dhe ekosistemeve.

5. Mekanizmi Ndërkombëtar i Varshavës do të bashkëpunojë me organet ekzistuese dhe grupet e ekspertëve sipas Marrëveshjes, si edhe organizatat përkatëse dhe organet eksperte jashtë Marrëveshjes.

Neni 9

1. Palët të cilat janë vende të zhvilluara do të ofrojnë burime financimi për të asistuar Palët të cilat janë vende në zhvillim në lidhje me zbutjen dhe adaptimin në vazhdimësi të detyrimeve të tyre sipas Konventës.

2. Palët e tjera inkurajohen që të ofrojnë ose të vazhdojnë që të ofrojnë një mbështetje të tillë vullnetare.

3. Si pjesë e një përpjekjeje globale, Palët të cilat janë shtete të zhvilluara, duhet të vazhdojnë të marrin drejtimin në mobilizimin e financimit të klimës nga një diversitet i gjerë burimesh, instrumentesh dhe kanalesh, duke theksuar rolin e rëndësishëm të fondeve publike, nëpërmjet një diversiteti veprimesh, duke përfshirë strategjitë e drejtuara nga shtetet dhe duke marrë në konsideratë nevojat dhe prioritetet e Palëve të cilat janë vende në zhvillim. Një mobilizim i tillë i financimit të klimës do të përfaqësojë një progres përtej përpjekjeve të mëparshme.

4. Sigurimi i burimeve financiare të përshkallëzuara/në rritje duhet të synojë që të arrijë një ekuilibër ndërmjet adaptimit dhe zbutjes, duke marrë në konsideratë strategjitë e drejtuara nga shtetet dhe prioritetet dhe nevojat e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, sidomos ato që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative të ndryshimit të klimës dhe kanë kufizime të rëndësishme kapaciteti, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël, duke marrë në konsideratë nevojën për burime publike dhe me baza grantesh për adaptim.

5. Palët të cilat janë vende në zhvillim do të komunikojnë çdo dy vjet informacion tregues

sasior dhe cilësor, në lidhje me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, si të jetë e aplikueshme, duke përfshirë, si të jetë e disponueshme, nivelet e projektuara të burimeve financiare publike, që do t'u ofrohen Palëve që janë vende në zhvillim. Palët e tjera që ofrojnë burime inkurajohen që të komunikojnë çdo dy vjet një informacion të tillë mbi baza vullnetare.

6. Analiza globale e referuar në nenin 14 do të marrë në konsideratë informacionin përkatës të ofruar nga Palët, të cilat janë vende të zhvilluara dhe/ose organet e Marrëveshjes, mbi përpjekjet në lidhje me financimin e klimës.

7. Palët që janë vende në zhvillim do të ofrojnë informacion transparent dhe të qëndrueshëm për mbështetjen për Palët të cilat janë vende në zhvillim, të siguruara dhe mobilizuara nëpërmjet ndërhyrjeve publike çdo dy vjet, në përputhje me modalitetet, procedurat dhe udhëzimet që do të miratohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, siç përcaktohet në nenin 13, paragrafi 13. Palët e tjera inkurajohen të veprojnë në këtë mënyrë.

8. Mekanizmi financiar i Konventës, duke përfshirë entitetet e saj operuese, do të shërbejë si një mekanizëm financiar i kësaj Marrëveshjeje.

9. Institucionet që i shërbejnë kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë entitetet operuese të Mekanizmit Financiar të Konventës, do të synojnë që të garantojnë akses efikas në burimet financiare, nëpërmjet procedurave të thjeshtuara të miratuara dhe mbështetje për gatishmërinë e përmirësuar për Palët të cilat janë vende në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara dhe shtete në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), në kontekstin e strategjive dhe planeve të tyre kombëtare për klimën.

Neni 10

1. Palët ndajnë një vizion afatgjatë mbi rëndësinë e realizimit të plotë të zhvillimit dhe transferimit të teknologjisë, në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë rikuperuese ndaj ndryshimit të klimës dhe për të reduktuar emetimet e gazit serrë.

2. Palët, duke theksuar rëndësinë e teknologjisë për zbatimin e veprimeve zbutëse dhe adaptuese, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe duke njohur përpjekjet ekzistuese për vendosjen dhe shpërndarjen e teknologjisë, do të forcojnë masat



bashkëpunuese mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë.

3. Mekanizmi i teknologjisë i krijuar sipas Konventës do t'i shërbejë kësaj Marrëveshjeje.

4. Nëpërmjet kësaj krijohet një kuadër teknologjie për të siguruar udhëzime gjithëpërfshirëse për punën e Mekanizmit të Teknologjisë, në promovimin dhe lehtësimin e veprimeve të përmirësuara për zhvillim dhe transferimin e teknologjisë, në mënyrë që të mbështesë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në zbatim të vizionit afatgjatë të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Përshpejtimi, inkurajimi dhe mundësimi i inovacionit është kritik për një reagim global afatgjatë ndaj ndryshimit të klimës dhe promovimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Përpjekje të tilla, si të jetë e përshtatshme, do të jenë të duhura, të mbështetura, duke përfshirë mekanizmin e teknologjisë dhe, nëpërmjet mjeteve financiare nga Mekanizmi Financiar i Konventës, për qasje bashkëpunuese për kërkim dhe zhvillim dhe duke lehtësuar aksesin në teknologji, në veçanti në fazat e hershme të ciklit të teknologjisë, për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

6. Mbështetja, duke përfshirë mbështetje financiare, do t'u ofrohet Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për zbatimin e këtij neni, duke përfshirë forcimin e veprimeve bashkëpunuese mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë në faza të ndryshme të ciklit të teknologjisë, me qëllim që të arrihet një balancë ndërmjet mbështetjes për zbutje dhe adaptim. Analiza globale, e referuar në nenin 14, do të marrë në konsideratë informacionin e disponueshëm mbi përpjekjet në lidhje me mbështetjen mbi zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë për Palët të cilat janë vende në zhvillim.

Neni 11

1. Ndërtimi i kapaciteteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të përmirësojë kapacitetin dhe mundësinë e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, në veçanti shtetet me kapacitetet më të ulëta, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe ato që janë në veçanti shtetet me kapacitetet më të ulëta, të tilla si vendet më pak të zhvilluara dhe ato që janë veçanërisht vulnerabël ndaj efekteve negative nga ndryshimi i klimës, të tilla si shtetet

në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS), për të marrë veprime efektive për ndryshimin e klimës, duke përfshirë, ndër të tjera, për të zbatuar veprimet e adaptimit dhe zbutjes dhe duhet të lehtësojnë zhvillimin e teknologjisë, përhapjen dhe vendosjen, aksesin në financimin e klimës, aspektet përkatëse të edukimit, trajnimit dhe ndërgjegjësimin të publikut dhe komunikimin transparent, në kohë dhe të saktë të informacionit.

2. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të drejtohet nga shteti, bazuar në dhe reagues ndaj nevojave kombëtare dhe të nxisë pronësi shteti të Palëve, në veçanti, për Palët të cilat janë vende në zhvillim, duke përfshirë nivelet kombëtare, nënkombëtare dhe lokale. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të drejtohet nga mësimet e marra, duke përfshirë ato nga aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve sipas Konventës dhe duhet të jetë një proces efektiv përsëritës që është pjesëmarrës, ndërsektorial dhe reagues/i përgjegjshëm ndaj gjinisë.

3. Të gjitha Palët duhet të bashkëpunojnë për të përmirësuar kapacitetin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për të zbatuar këtë Marrëveshje. Palët, që janë vende të zhvilluara, duhet të përmirësojnë mbështetjen për masat e ndërtimit të kapaciteteve të Palët të cilat janë vende në zhvillim.

4. Të gjitha Palët që përmirësojnë kapacitetin e Palëve të cilat janë vende në zhvillim, për të zbatuar këtë Marrëveshje, duke përfshirë nëpërmjet qasjeve rajonale, bilaterale dhe multilaterale, do të komunikojnë rregullisht mbi këto veprime ose masa për ndërtimin e kapaciteteve. Palët, që janë vende në zhvillim, duhet të komunikojnë rregullisht progresin e bërë mbi zbatimin e planeve, politikave apo masave të ndërtimit të kapaciteteve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve do të përmirësohen nëpërmjet marrëveshjeve të duhura institucionale, për të mbështetur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë marrëveshjet e duhura institucionale të krijuara sipas Konventës që i shërben kësaj Marrëveshjeje. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, do të marrë në konsideratë dhe do të miratojë një vendim mbi marrëveshjet institucionale fillestare për ndërtimin e kapaciteteve.



Neni 12

Palët do të bashkëpunojnë në marrjen e masave, si të jetë e përshtatshme, për të përmirësuar edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e publikut, pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin e publikut në informacion, për ndryshim e klimës, duke njohur rëndësinë e këtyre hapave në lidhje me përmirësimin e veprimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

1. Në mënyrë që të ndërtohet besim dhe mirëbesim reciprok dhe për të promovuar zbatim efektiv, nëpërmjet kësaj krijohet një kuadër transparence i përmirësuar për veprim dhe mbështetje, me fleksibilitet të ndërtuar, i cili merr në konsideratë kapacitetet e ndryshme të Palëve dhe bazohet në përvojën kolektive.

2. Kuadri i transparencës do të ofrojë fleksibilitet në zbatimin e dispozitave të këtij neni, për ato Palë që janë vende në zhvillim, që kanë nevojë në bazë të kapaciteteve të tyre. Modalitetet, procedurat dhe udhëzimet e referuara në paragrafin 13 të këtij neni do të reflektojnë një fleksibilitet të tillë.

3. Kuadri i transparencës do të bazohet në dhe do të përmirësojë marrëveshjet e transparencës sipas Konventës, duke njohur rrethanat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim që janë ishuj të vegjël (SIDS) dhe të zbatohet në një mënyrë lehtësuese, jondërhyrëse dhe jondëshkuese, duke respektuar sovranitetin kombëtar dhe duke evituar vendosjen e ngarkesave të panevojshme mbi Palët.

4. Marrëveshjet e transparencës sipas Konventës, duke përfshirë komunikimet kombëtare, raportet dyvjeçare dhe raportet e përditësuara dyvjeçare, vlerësimin dhe rishikimin ndërkombëtar dhe konsultimin dhe analizimin ndërkombëtar, do të përbëjnë pjesë të përvojës të hartuar mbi zhvillimin e modaliteteve, procedurave dhe udhëzimeve, sipas paragrafit 13 të këtij neni.

5. Qëllimi i kuadrit për transparencë të veprimeve është që të ofrojë një kuptim të qartë të veprimeve për ndryshimin e klimës në bazë të objektivit të Konventës, siç është përcaktuar në nenin 2 të saj, duke përfshirë qartësi dhe gjurmim të progresit drejt arritjes së kontributeve individuale të përcaktuara në nivel kombëtar të Palëve,

sipas nenit 4 dhe veprimet e adaptimit të Palëve sipas nenit 7, duke përfshirë praktikën e mira, prioritetet, nevojat dhe boshllëqet për të informuar analizën globale, sipas nenit 14.

6. Qëllimi i kuadrit për transparencë të mbështetjes është që të ofrojë qartësi mbi mbështetjen e ofruar dhe të marrë nga Palët individuale përkatëse në kontekstin e veprimeve për ndryshimin e klimës sipas neneve 4, 7, 10 dhe 11 dhe sa më shumë që të jetë e mundur, të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të plotë të mbështetjes financiare të grumbulluar që është ofruar, për të informuar analizën globale sipas nenit 14.

7. Secila Palë do të ofrojë rregullisht informacionin e mëposhtëm:

a) një raport-inventar kombëtar të emetimeve antropogjene nga burimet dhe heqjet nga vaskat e gazit serrë, të përgatitur duke përdorur metodologjitë e praktikave të mira të pranuar nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimin e Klimës dhe për të cilin është rënë dakord nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit;

b) informacion të nevojshëm për të gjurmuar progresin e bërë në zbatimin dhe arritjen e kontributit të tyre të përcaktuar në nivel kombëtar sipas nenit 4.

8. Secila Palë duhet, gjithashtu, të ofrojë informacion në lidhje me ndikimet e ndryshimit të klimës dhe adaptimit sipas nenit 7, si të jetë e përshtatshme.

9. Palët të cilat janë vende të zhvilluara dhe Palë të tjera të cilat ofrojnë mbështetje, duhet të ofrojnë informacion mbi mbështetjen financiare, transferimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve që u është ofruar Palëve të cilat janë vende në zhvillim sipas nenit 9, 10 dhe 11.

10. Palët të cilat janë vende në zhvillim duhet të ofrojnë informacion mbi mbështetjen financiar, për transferimin e teknologjisë dhe për ndërtimin e kapaciteteve që ato kanë nevojë dhe që kanë marrë sipas neneve 9, 10 dhe 11.

11. Informacioni i dorëzuar nga secila Palë sipas paragrafëve 7 deri 9 të këtij neni, do t'i nënshtrohet një rishikimi ekspert teknik, në përputhje me vendimin 1/CP.21. Për ato Palë të cilat janë vende në zhvillim, që kanë nevojë për të, në bazë të kapaciteteve të tyre, procesi i rishikimit do të përfshijë asistencë në identifi-



kimin e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve. Për më tepër, secila Palë do të marrë pjesë në një konsideratë progresi lehtësuese multilaterale, në lidhje me përpjekjet sipas nenit 9 dhe zbatimin e saj përkatës dhe arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar.

12. Rishikimi ekspert teknik, sipas këtij paragrafi, do të konsistojë një konsideratë të mbështetjes të ofruar për Palën, si të jetë relevante dhe zbatimin e saj dhe arritjen e kontributit të saj të përcaktuar në nivel kombëtar. Rishikimi do të identifikojë, gjithashtu, fushat e përmirësimit për Palën dhe do të përfshijë një rishikim të përputhshmërisë së informacionit me modalitetet, procedurat dhe udhëzimet e referuara në paragrafin 13 të këtij neni, duke marrë në konsideratë fleksibilitetin e dhënë Palës sipas paragrafit 2 të këtij neni. Rishikimi do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aftësive përkatëse kombëtare dhe rrethanave të Palëve të cilat janë shtete në zhvillim.

13. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë, duke ndërtuar mbi përvojën nga marrëveshjet në lidhje me transparencën sipas Konventës dhe duke përpunuar mbi dispozitat e këtij neni, do të miratojë modalitete, procedurat dhe udhëzimet, si të jetë e përshtatshme, për transparencën e veprimeve dhe mbështetjes.

14. Vendeve në zhvillim do t'u ofrohet mbështetje për zbatimin e këtij neni.

15. Do të ofrohet, gjithashtu, mbështetje për ndërtimin e kapacitetit në lidhje me transparencën e Palëve, të cilat janë vende në zhvillim mbi baza të vazhdueshme.

Neni 14

1. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të analizojë periodikisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për të vlerësuar progresin kolektiv drejt arritjes së qëllimit të kësaj Marrëveshjeje dhe qëllimet e saj afatgjata (e referuar si “analiza globale”). Do të veprojë kështu në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe lehtësuese, duke marrë në konsideratë zbutjen, adaptimin dhe mjetet e zbatimit dhe mbështetjen dhe në bazë të barazisë dhe shkencës më të mirë të disponueshme.

2. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të

ndërmarrë analizën e parë globale në vitin 2023 dhe më pas çdo pesë vjet, me përjashtim nëse vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

3. Rezultati i analizës globale do të informojë Palët në përditësim dhe përmirësim, në një mënyrë të përcaktuar në nivel kombëtar, veprimet e tyre dhe mbështetjen në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, si edhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndër-kombëtare për veprime klimatike.

Neni 15

1. Nëpërmjet kësaj themelohet një mekanizëm për të lehtësuar zbatimin dhe për të promovuar përputhshmëri me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Mekanizmi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijë një komitet që do të bazohet në ekspertë dhe do të jetë lehtësues në natyrë dhe në funksion, në një mënyrë që të jetë transparent, i pakundërshtueshëm dhe jondëshkues. Komiteti do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aftësive kombëtare përkatëse dhe rrethanave të Palëve.

3. Komiteti do të operojë sipas modaliteteve dhe procedurave të miratuara nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, në sesionin e saj të parë dhe i raporton çdo vit Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

Neni 16

1. Konferenca e Palëve, organi suprem i Konventës, do të shërbejë si takimi i Palëve për këtë Marrëveshjeje.

2. Palët e Konventës, të cilat nuk janë Palë të kësaj Marrëveshjeje, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procedurat e çdo sesioni të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshjeje. Kur Konferenca e Palëve shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshjeje, vendimet për këtë Marrëveshjeje do të merren vetëm nga ato që janë Palë e kësaj Marrëveshjeje.

3. Kur Konferenca e Palëve shërben si takim i Palëve për këtë Marrëveshjeje, çdo anëtar i Byrosë së Konferencës së Palëve që përfaqëson një Palë në Konventë, por në atë moment nuk është një Palë e kësaj Marrëveshjeje, do të zëvendësohet



nga një anëtar shtesë që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje.

4. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbajë nën shqyrtim të rregullt zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe brenda mandatit të saj do të marrë vendimet e nevojshme për të nxitur zbatimin e saj efektiv. Ajo do të kryejë funksionet që i janë caktuar nga kjo Marrëveshje dhe do të:

a) themelojë organe ndihmëse të tilla si të jetë e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) ushtrojë funksione të tjera, siç mund të kërkojnë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Rregullat e procedurës së Konferencës së Palëve dhe procedurat financiare të zbatuara sipas Konventës do të zbatohen *mutatis mutandis*, sipas kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim, siç mund të jetë vendosur ndryshe, me konsensus nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

6. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mblidhet nga sekretariati në bashkëpunim me sesionin e parë të Konferencës së Palëve, që është planifikuar pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Sesionet e zakonshme vijuese të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbahen në bashkëpunim/kombinim me sesionet e zakonshme të Konferencës së Palëve, me përjashtim nëse vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim për Marrëveshjen e Parisit.

7. Sesione të jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, do të mbahen në momente të tjera, siç mund të shikohet e nevojshme nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit ose me kërkesë me shkrim nga ndonjëra nga Palët, parashikuar që, brenda gjashtë muajve që është komunikuar kërkesa te Palët nga sekretariati, ajo mbështetet nga të paktën një e treta e Palëve.

8. Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si edhe çdo shtet anëtar prej tyre ose vëzhgues të tyre që nuk janë Palë me Konventën, mund të përfaqësohen në sesionet e

Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, si vëzhgues. Çdo organ apo agjenci, qoftë kombëtare apo ndërkombëtare, qeveritare apo joqeveritare, e cila është e kualifikuar në çështjet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe që ka informuar sekretariatit për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një sesion të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, si një vëzhgues, mund të jetë e tillë me përjashtim nëse të paktën një e treta e Palëve të pranishme e kundërshtojnë. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do të jenë subjekt rregullave të procedurës së referuar në paragrafin 5 të këtij neni.

Neni 17

1. Sekretariati i themeluar nga neni 8 i Konventës do të shërbejë si sekretariat i kësaj Marrëveshjeje.

2. Neni 8, paragrafi 2 i Konventës, mbi funksionet e sekretariatit dhe neni 8, paragrafi 3 i Konventës mbi marrëveshjet e bëra për funksionimin e sekretariatit, do të zbatohet *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje. Sekretariati, për më tepër, do të ushtrojë funksionet e përcaktuara atij sipas Marrëveshjes dhe nga Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit.

Neni 18

1. Organi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndihmës për Zbatimin, të themeluar nga nenet 9 dhe 10 të Konventës do të shërbejnë përkatësisht si Organi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndihmës për Zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e Konventës që lidhen me funksionimin e këtyre dy organeve do të zbatohet *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje. Sesionet e takimit të Organit Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndihmës për Zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të mbahen në bashkëpunim/kombinim me takimet, përkatësisht, Organi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndihmës për Zbatim të Konventës.

2. Palët e Konventës që nuk janë Palë e kësaj Marrëveshjeje, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procedurat e çdo sesioni të organeve ndihmëse.



Kur organet ndihmëse shërbejnë si organet ndihmëse të kësaj Marrëveshjeje, vendimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të merren vetëm nga ato që janë Palë në këtë Marrëveshje.

3. Kur organet ndihmëse, të themeluara nga nenet 9 dhe 10 të Konventës, ushtrojnë funksionet e tyre në lidhje me çështjet që lidhen me këtë Marrëveshje, çdo anëtar i byrove të atyre organeve ndihmëse që përfaqësojnë një Palë në Konventë, por në atë moment jo Palë e kësaj Marrëveshjeje, do të zëvendësohet nga një anëtar shtesë që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

1. Organet ndihmëse ose marrëveshje të tjera institucionale, të themeluara nga dhe sipas Konventës, të ndryshme nga ato të referuara në këtë Marrëveshje, do t'i shërbejnë kësaj Marrëveshjeje me vendim të Konferencës së Palëve që shërben si takim i Palëve të Marrëveshjes së Parisit. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve të Marrëveshjes së Parisit, do të specifikojë funksionet e ushtruara nga këto organe apo marrëveshje.

2. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i Palëve për Marrëveshjen e Parisit, mund të ofrojë udhëzim të mëtejshëm për organe të tilla ndihmëse dhe marrëveshje institucionale.

Neni 20

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim dhe subjekt për ratifikim, pranimit dhe miratim nga shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të cilat janë Palë të Konventës. Ajo do të jetë e hapur për nënshkrim në Zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga data 22 prill 2016 deri më 21 prill 2017. Më pas, kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga dita pas datës në të cilën është mbyllur për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen te Depozitari.

2. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik që bëhet Palë e kësaj Marrëveshjeje, ku asnjë nga shtetet e tyre anëtare nuk është Palë, do të jetë e detyruar t'u përmbahet të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje. Në rastin e organizatave rajonale të integritit ekonomik, ku një ose më shumë shtete anëtare janë Palë e kësaj

Marrëveshjeje, organizata dhe shteti i saj anëtar do të vendosin mbi përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas kësaj Marrëveshjeje. Në raste të tilla, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të jenë të autorizuar të ushtrojnë të drejta njëkohësisht sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, organizatat rajonale të integritit ekonomik do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje. Këto organizata do të informojnë, gjithashtu, Depozitarin, i cili nga ana e tij do të informojë Palët për çdo modifikim thelbësor në shtrirjen e kompetencave të tyre.

Neni 21

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën të paktën 55 Palë të Konventës, që përbëjnë në total të paktën një përlllogaritje prej 55 për qind të emetimeve globale të gazit serrë kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Vetëm për qëllimin e kufizuar të paragrafit 1 të këtij neni, “emetimet totale globale të gazit serrë” nënkupton shumën/sasinë, më të fundit të përditësuar, të komunikuar më ose përpara datës së miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Palët e Konventës.

3. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik që ratifikon, pranon apo miraton këtë Marrëveshje ose aderon në të pasi janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për hyrjen në fuqi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet apo organizatë rajonale të integritit ekonomik të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

4. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale të integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga shteti i saj anëtar.

Neni 22

Dispozitat e nenit 15 të Konventës, mbi miratimin e amendamenteve të Konventës, do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.



Neni 23

1. Dispozitat e nenit 16 të Konventës, mbi miratimin dhe amendimin e anekseve të Konventës, do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

2. Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe me përjashtim nëse është parashikuar shprehimisht ndryshe, një referencë ndaj kësaj Marrëveshjeje përbën në të njëjtën kohë një referencë për secilin nga anekset e saj. Këto anekse do të jenë të kufizuar në lista, formate dhe çdo material tjetër të një natyre përshkruese që është e një karakteri shkencor, teknik, procedural ose administrativ.

Neni 24

Dispozitat e nenit 14 të Konventës mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

Neni 25

1. Secila Palë do të ketë një votë, me përjashtim kur është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Organizatat rajonale të integritimit ekonomik, në çështjet brenda kompetencave të tyre, do të ushtrojnë të drejtën për të votuar me një numër votash të barabartë me ato të shteteve të tyre anëtare që janë Palë të kësaj Marrëveshjeje. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën për të votuar nëse shteti i saj anëtar ushtron të drejtën e tij dhe anasjelltas.

Neni 26

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë Depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë ndaj kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

1. Në çdo kohë, pas tri viteve nga data në të cilën kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi për një Palë, ajo Palë mund të tërhiqet nga Marrëveshja duke dhënë një njoftim më shkrim te Depozitari.

2. Çdo tërheqje e tillë do të marrë efekt me skadimin e një viti, nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes nga Depozitari ose në datën e kësaj letre, siç mund të jetë specifikuar në njoftimin për tërheqje.

3. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa do të konsiderohet që është tërhequr, gjithashtu, edhe nga Marrëveshja.

Neni 29

Originali i kësaj Marrëveshjeje, tekstet e së cilës në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Paris, sot, në ditën e dymbëdhjetë të dhjetorit, dy mijë e pesëmbëdhjetë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

LIGJ

Nr. 78/2016

**PËR ZHVILLIMIN DHE
PJESËMARRJEN E FORCAVE
USHTARAKE TË BRITANISË SË
MADHE NË STËRVITJEN E
PËRBASHKËT “ALBANIAN LION 2016”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët “Albanian Lion 2016”, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 1 500 (një mijë e pesëqind) trupave ushtarake të Britanisë së Madhe, pjesëmarrës në stërvitje.

Neni 3

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit, nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.



Neni 4

Stërvitja “Albanian Lion 2016” zhvillohet në periudhën 17 shtator – 8 tetor 2016, në gadi-shullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos, bazën ajrore Kuçovë dhe Rinas, Bizë, kepi i Palit, Zall-Herr, si dhe në rrugëkalimet ajrore e tokësore për në këto rajone.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 1 500 (një mijë e pesëqind) trupa ushtarake të Britanisë së Madhe, 4 (katër) anije luftarake 1 (një) helikoptermbajtëse, 1 (një) fregatë dhe 2 (dy) anije zbarkuese, 3 (tre) avionë ushtarakë HAWK Jets dhe 10 (dhjetë) helikopterë, 2 Chinook, 4 AH64, 2 Marlin Mk2, 2 (WILDCAT), të cilët do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4, të këtij ligji.

Neni 6

Trupat britanikë, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat britanikë do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9711, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 79/2016

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGISË DHE INDUSTRIISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE ACR HOLDING, S.R.L., SI KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E MINIERËS SË KROMIT, BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT, BULQIZË, TË IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT, KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT, BURREL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe ACR Holding, s.r.l., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Minierës së Kromit, Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit, Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit, Klos, dhe të Uzinës së Ferrokromit, Burrel, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9712, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



SHTESË E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT

NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË
DHE INDUSTRI SË, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE ACR HOLDING, SI
KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN,
OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E
MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, TË
FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË
IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS
DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT
BURREL

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Koncesionit (Marrëveshje) është nënshkruar në datën 26.5.2016, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), me adresë në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si “Autoriteti Kontraktues”), përfaqësuar nga z. Damian Gjijnuri, ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe ACR Holding s.r.l., një shoqëri e së drejtës italiane, me seli të shoqërisë në Milano, Itali, përfaqësuar nga z. Eglant Pupa, administrator i ACR Holding s.r.l. (këtu e më poshtë referuar si “Koncesionari”). Secili prej Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit do të quhen individualisht “Pala” dhe bashkërisht “Palët”,

Meqenëse:

A. Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe “Darfo” s.p.a., në datën 14.4.2001, është firmosur një marrëveshje koncesioni e formës ROT (Marrëveshja e Koncesionit), e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 8791, datë 10.5.2001, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës italiane “Darfo” s.p.a., si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për Koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje”;

B. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e ka shpallur si sektor të rëndësishëm sektorin minerar dhe kërkon që të vitalizojë investimet në këtë sektor;

C. Në vitin 2005, shoqëria “Darfo” s.p.a. u shndërrua nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Darfo” s.r.l.;

Ç. Në vitin 2010, “Darfo” s.r.l. ndryshoi emërtimin në ACR Holding s.r.l.;

D. Në vitin 2013, Balfin Group bleu 100% të kuotave të shoqërisë ACR Holding s.r.l. si mbajtëse e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së koncesionit;

Dh. Ministria e Energjisë dhe Industrisë është ministria përgjegjëse për sektorin minerar dhe Autoritet Kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

E. Balfin Group, nëpërmjet Koncesionarit dhe shoqërisë koncesionare Albchrome sh.p.k., në periudhën kohore 2013–2015, ka investuar rreth 11,5 milionë USD;

Ë. Palët njohin faktin se që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Koncesionit dhe deri në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në legjislacionin që lidhen me kontratat e koncesionit, si dhe në atë minerar dhe se është e domosdoshme që bashkëpunimi mes Palëve të marrë në konsideratë këto ndryshime;

F. Palët njohin dhe pranojnë faktin që për një shfrytëzim optimal dhe eficient të burimeve minerale të dhëna në koncesion, është i nevojshëm përditësimi, shtimi dhe/ose ndryshimi i investimeve dhe prioriteteve të këtyre investimeve të përcaktuara fillimisht në Marrëveshjen e Koncesionit; si dhe

G. Shoqëria koncesionare Albchrome sh.p.k., është pajisur me lejen minerare nr. 677, datë 16.9.2002, të ndryshuar, së fundmi i ndryshuar me urdhrin nr. 234, datë 30.6.2014, të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, ku përcaktohen, ndërmjet të tjerave, dhe koordinatat dhe kuotat e pikave kufizuese të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare.

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Interpretimi

Përveçse kur ndryshohen shprehimisht nga kjo Marrëveshje, dispozitat e Marrëveshjes së Koncesionit do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë dhe detyrues për Palët.

Kjo Marrëveshje bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit dhe kudo ku përdoret termi “Marrëveshje Koncesioni” do të konsiderohet se ky term përfshin edhe këtë Marrëveshje.



Neni 2

Përkufizimet

Në nenin 1 të Marrëveshjes së Koncesionit, “Përkufizimet”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Përkufizimi “Koncesionari”, ndryshon si më poshtë:

“Koncesionari” ka kuptimin që i është dhënë në këtë Marrëveshje.

Përkufizimi “Forcë madhore”, ndryshon si më poshtë:

“Forcë madhore” do të thotë çdo rrethanë që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të njëres Palë (Pala e Cenuar) për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;

b) Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masa të arsyeshme alternative, në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Koncesioni dhe për të zbutur pasojat e saj;

c) ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit; dhe

d) Pala e Cenuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër për këtë rast të forcës madhore.

Pa kufizuar frymën e përgjithshme të paragrafit më sipër, secila nga rrethanat e mëposhtme, në masën që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafët më sipër, do të përbëjë rast të forcës madhore:

a) veprimet e luftës, pushtimi ose aktet e një armiku të huaj, ose akte të terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

b) akte të rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit, ose sabotazhi me natyrë politike apo të çdolloj natyre tjetër;

c) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

d) epidemia; dhe

e) grevat ose veprimtaritë për të ndaluar dhe/ose për të ngadalësuar punën.

Përkufizimi “Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)”, ndryshon si më poshtë:

“Autoriteti Kontraktues” është ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe që legjislacioni në fuqi e ka autorizuar të jetë si palë për efekt të kësaj Marrëveshjeje dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit;

Kudo ku në Marrëveshjen e Koncesionit është përdorur termi “Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)”, do të zëvendësohet nga termi “Autoriteti Kontraktues”.

Përkufizimi “Palët”, ndryshon si më poshtë;

“Palët” ka kuptimin që i është dhënë në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.

Përkufizimi “Periudha e koncesionit”, ndryshon si më poshtë:

“Periudha e Koncesionit” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 8 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Pas përkufizimit “Shoqëri koncesionare” shtohen përkufizimet e mëposhtme:

“Marrëveshje” ka kuptimin që i është dhënë në hyrje të Marrëveshjes.

“Ditë pune” do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare.

“Plani i ri i investimeve” do të thotë investimet e reja që do të kryhen nga Koncesionari dhe që specifikohen në aneksin nr. 2, i cili do të zëvendësojë anekset 2 dhe 3 të Marrëveshjes Koncesionare.

“Raporti i Progresit”, do të thotë dokumenti i përgatitur çdo vit nga Koncesionari dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktor, ku paraqitet ecuria e investimeve të realizuara gjatë vitit, investimet e parrealizuara, shkaqet e mosrealizimit të tyre, propozimet për ndryshimet e zërave dhe/ose vlerave të investimeve të parashikuara për t'u realizuar nga Koncesionari, si dhe masat që duhet të ndërmarrin Palët për kryerjen e investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

“Objekt i Koncesionit” do të thotë objektet dhe/ose asetet e përmendura në nenin 2 të Kontratës së Koncesionit, si dhe në aneksin nr. 1, i ndryshuar.

“Financuesit e Projektit” do të thotë çdo person apo persona që financojnë apo rifinancojnë borxhe



(hua) të Koncesionarit apo/dhe shoqërisë koncesionare, në lidhje me Projektin.

“Person” do të thotë çdo individ, person fizik apo shoqëri tregtare, e themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar, ndërmarrje, institucion publik i pushtetit qendror, vendor apo i pavarur (në çdo rast, me ose pa personalitet juridik të veçantë).

Neni 3

Kriteret specifike të punimeve

Neni 3.1 i Marrëveshjes së Koncesionit, “Kriteret specifike të punimeve”, ndryshohet si më poshtë vijon:

A. Në Minierën e Bulqizës do të realizohen këto investime:

1. Zhvillimi i pjesës veriore, hapja në thellësi, pusi nr. 9;
2. Zhvillimi i vendburimit të Qafë-Buallit;
3. Hapja e tranberbankut të Klosit.

B. Në Uzinën e Ferrokromit Burrel do të realizohen këto investime:

1. Rikonstruksioni i furrës ekzistuese;
2. Ndërtimi i një furre të re në UFK Burrel.

Në total, brenda 8 (tetë) viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në pjesën veriore të Minierës së Bulqizës, Sektorin Qafë-Bualli dhe Uzinën e Ferrokromit Burrel, parashikohet të investohen rreth 24,214,505 USD, sipas specifikimeve, kushteve dhe shpërndarjes së dhënë në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3.2 i kontratës së koncesionit, ndryshon si më poshtë:

“Koncesionari do të marrë masat që të vërë në zbatim/implementojë brenda periudhës së pritshme, prej 8 (tetë) vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje (“Periudha e investimeve”), shumën e investimeve të përshkruara në planin e ri të investimeve, duke marrë parasysh tregun dhe kushtet tregtare në Shqipëri apo në tregjet ndërkombëtare.

Për efekt të llogaritjes dhe të kontrollit të vazhdueshëm të investimeve të detajuara në aneksin 2 (përfshirë dhe ndryshimet që palët mund t’i bëjnë këtij aneksi në përputhje me këtë Marrëveshjeje), periudha e investimeve do të ndahet në tri faza: i) faza e parë do të jetë periudha trevjeçare, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje (në vijim “faza e parë e investimeve”); ii) faza e dytë do të jetë periudha trevjeçare, duke filluar nga dita e parë pas

përfundimit të fazës së parë të investimeve (në vijim “faza e dytë e investimeve”); si dhe iii) faza e tretë do të jetë periudha dyvjeçare, duke filluar nga dita e parë pas përfundimit të fazës së dytë të investimeve (“faza e tretë e investimeve” dhe së bashku me fazën e parë të investimeve dhe fazën e dytë të investimeve, në vijim “fazat e investimeve”).

Nëse Koncesionari ka bërë më shumë investime se sa është parashikuar në aneksin 2, për një fazë investimi dhe këto investime janë konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë teprica e këtij investimi do t’i llogaritet si investim i bërë në fazën pasardhëse. Nëse Koncesionari ka bërë më pak investime se sa është parashikuar në aneksin 2, për një fazë investimi dhe kjo është e konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues si kusht penal vlerësues, një shumë (e referuar më poshtë si një “shumë penaliteti”), që llogaritet duke aplikuar përqindjen përkatëse të përcaktuar më poshtë, mbi totalin e miratuar të investimeve për fazën e investimit përkatëse minus çdo shumë të investuar konkretisht nga ana e Koncesionarit (dhe të konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore) për atë fazë. Diferenca ndërmjet totalit të miratuar të investimeve për një fazë investimesh dhe investimeve aktuale për atë fazë do të referohet si investimi i munguar. Shuma e penalitetit do të jetë e barabartë me 10% të investimit të munguar.

Çdo shumë penaliteti do të paguhet nga Koncesionari Autoritetit Kontraktues në përfundim të çdo faze investimesh, brenda 2 (dy) muajve nga kërkesa me shkrim që i dorëzohet Koncesionarit, për këtë qëllim, duke përfshirë dhe një detajim të hollësishëm për llogaritjen, sipas raportit të progresit në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Nëse pagesa nuk ndodh brenda periudhës 2-mujore sipas paragrafit më sipër, Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues një kamatëvonesë, të barabartë me kamatëvonesën ligjore të përcaktuar sipas legjislacionit shqiptar.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse investimet e planifikuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, nuk janë kryer në kohë për shkak të forcës madhore dhe për sa kohë zgjat efekti i kësaj force madhore apo për shkak të një mospërmbushjeje të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, atëherë



Koncesionari nuk do të jetë i detyruar të paguajë asnjë shumë penalteti ndaj Autoritetit Kontraktues.

Për shmangien e çdo dyshimi, pagesa e shumës së penaltetit për çdo fazë investimesh përfaqëson shpërblimin e dëmit dhe detyrimin e vetëm që ka Koncesionari ndaj Autoritetit Kontraktues për mospërbushjen e detyrimit të tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit në lidhje me mospërbushjen e tij për kryerjen e investimeve.

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje në lidhje me përcaktimin e shumës së penaltetit dhe/ose pagesën e saj do të zgjidhet sipas nenit 21 të Marrëveshjes së Koncesionit.”.

Neni 4

Koha e fillimit të punimeve

Në nenin 4 të Kontratës së Koncesionit, pas paragrafit 4.2 shtohet paragrafi 4.3 me këtë përmbajtje:

“4.3 Punimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, fillojnë dhe kryhen në përputhje me grafikun e planit të ri të investimeve, i cili është parashikuar në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.”.

Neni 5

Detyrimet e Koncesionarit

Në nenin 5 të Marrëveshjes së Koncesionit, paragrafi 5.3 ndryshon si më poshtë:

“5.3 Të respektojë të drejtën e Autoritetit Kontraktor për ruajtjen e pronësisë së mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncension, për sa kohë ato nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi apo bërë të pamundura për t'u rikuperuar nga Koncesionari.

Pavarësisht kësaj, Koncesionari ka detyrimin për të dorëzuar në gjendje pune dhe në pronësi të Autoritetit Kontraktues, çdo mjet kryesor (inventarit) të marrë në koncension që Koncesionari ka zëvendësuar, rehabilituar, përmirësuar gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Koncesionit, duke pasur parasysh, gjithashtu, amortizimin që këto mjete kanë pësuar që nga koha e zëvendësimit, rehabilitimit apo përmirësimit.

Koncesionari në rastin e zëvendësimit, rehabilitimit, rikuperimit, nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncension, njofton Autoritetin Kontraktues.

Koncesionari, me miratim të Autoritetit Kontraktues, mund të transferojë pjesë nga mjetet kryesore (inventarit) të marra në koncension dhe që

nuk i shërbejnë më qëllimit të koncensionit, një personi të tretë publik, duke respektuar procedurat ligjore që kërkon Autoriteti Kontraktues, si dhe duke e shoqëruar këtë transferim me dokumentacionin përkatës ligjor”.

Neni 6

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Në nenin 6 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit “f” shtohen paragrafët “g”, “h” dhe “i” me këtë përmbajtje:

“g) Autoriteti Kontraktues, brenda kompetencave të tij ligjore do të pajisë Koncesionarin me të gjitha lejet, licencat, autorizimet dhe me çdo akt tjetër, në përgjegjësi të tij, të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare dhe do të bëjë në kohë ripërtëritjen, zëvendësimin, zgjatjen e lejeve, licencave apo autorizimeve që ekzistojnë në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Koncesionari të ketë dorëzuar në kohë dhe konform legjislacionit shqiptar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në formën dhe në përmbajtjen e kërkuar. Autoriteti Kontraktues nuk do t'i shfuqizojë, revokojë apo bëjë të pavlefshme këto leje, autorizime apo licenca gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare apo të vendosë detyrime të tjera shtesë ndaj Koncesionarit për marrjen, zgjatjen, ripërtëritjen, vlefshmërinë e këtyre lejeve, licencave, autorizimeve apo çdo akt/veprim tjetër, si kusht për të kryer njërën, disa apo të gjitha nga veprimet/aktet e përmendura në këtë paragraf, me kusht që Koncesionari të ketë respektuar kërkesat që ka legjislacioni shqiptar për këto leje, licenca, autorizime.

h) Autoriteti Kontraktues do të asistojë, në institucionet përgjegjëse, Koncesionarin për pajisjen me çdo leje, licencë, autorizim tjetër të nevojshëm për aktivitetin koncesionar gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncensionit.

i) Autoriteti Kontraktues, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Marrëveshjen e Koncesionit, do të mbajë të padëmtuar Koncesionarin nga çdo pasojë që i vjen këtij të fundit nga dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përgjithësi nga dështimi i tij për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij të shprehura në Marrëveshjen e



Koncesionit, këtë Marrëveshje dhe/ose detyrimet e tij sipas legjislacionit.”.

Neni 7

Miratimi i planit të investimit

Në nenin 7 të Marrëveshjes së Koncesionit, “Vlerësimi i investimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Titulli i nenit 7, ndryshon nga “Vlerësimi i investimit”, në “Miratimi i planit të investimeve”.

Paragrafi 7.2 i nenit 7 të Marrëveshjes së Koncesionit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.2 Brenda datës 31 të muajit mars të çdo viti, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktues raportin e progresit në të cilin paraqet ecurinë e investimeve të vitit paraardhës, si dhe ecurinë progresive të investimeve nga fillimi i planit të ri të investimeve deri në fundin e vitit paraardhës. Raporti i progresit shoqërohet me shpjegime të hollësishme për investimet e realizuara, investimet e parealizuara, arsyet e mosrealizimeve nëse ka, masat që do të ndërmerren nga Koncesionari për realizimin e investimeve që nuk janë kryer gjatë vitit paraardhës, veprimet që kërkohen të ndërmerren nga Autoriteti Kontraktues në përmbushje të detyrimeve të tij kontraktuale dhe/ose ligjore, nevojat për investime të reja, nevojat për ndryshime të zërave të investimeve.”.

Pas paragrafit 7.2 shtohen paragrafët 7.3, 7.4, 7.5 dhe 7.6 me këtë përmbajtje:

7.3 Brenda 2 javëve nga marrja e raportit të progresit, personat e autorizuar të Palëve, nëse është nevoja, shqyrtojnë së bashku raport-progresin, si dhe për masat që duhen marrë nga Palët për zbatimin e këtij plani të ri të investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

7.4 Diskutimet për planin e investimeve të vitit ushtrimor, përfundojnë brenda 2 javëve nga takimi i parë sipas paragrafit 7.3 më sipër dhe, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga dita e paraqitjes së raportit të progresit.

7.5 Palët evidentojnë në një dokument të firmosur nga ato (Palët) masat që duhet të ndërmerren nga Palët për zbatimin e planit të ri të investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

7.6 Nëse Koncesionari konstaton se për shkak të ndryshimit të rrethanave është e nevojshme ndryshimi i planit të ri të investimeve, ai i paraqet, në formë të shkruar, Autoritetit arsyet dhe nevojat e këtij ndryshimi, si dhe investimet që ai mendon se

duhen ndryshuar. Procedurat, format dhe afatet e paraqitjes dhe diskutimit të ndryshimeve në planin e ri të investimeve, janë të njëjta me ato të përshkruara në paragrafët 7.3, 7.4 dhe 7.5 më sipër. Vlera e pakësimit të investimit, nëse është e nevojshme, nuk do të jetë më shumë se 10% të vlerës të investimeve, të specifikuar në nenin 3.1 të kësaj Marrëveshjeje.

7.7 Nëse Palët arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e planit të ri të investimeve, kjo Marrëveshje evidentohet në formë të shkruar (në formën e një dokumenti të firmosur nga të dyja palët). Ky dokument ka fuqi detyruese për Palët dhe bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit.

7.8 Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e planit të ri të investimeve sipas parashikimeve të paragrafëve 7.6 dhe 7.7 më sipër, Koncesionari, për aq sa është e mundur, do të vazhdojë me implementimin e planit të ri të investimeve sipas parashikimeve të aneksit nr. 2.”.

Neni 8

Periudha e koncesionit

Neni 8.1 i kontratës së koncesionit ndryshon si më poshtë:

“8.1 Periudha e koncesionit përfundon më 31 dhjetor 2040.”.

Neni 8.2, shfuqizohet.

Neni 9

Mbështetja për projektin

Në nenin 10 të kontratës së koncesionit, “Mbështetja për projektin”, paragrafi 10.2 i nenit 10 të kontratës së koncesionit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“10.2 Autoriteti Kontraktor bëhet garant që TVSH-ja do të rimburohet rregullisht, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së nga ana e shoqërisë koncesionare.”.

Neni 10

Transferimi dhe garancitë

Me përjashtim kur është parashikuar ndryshe në Marrëveshjen e Koncesionit apo/dhe në këtë Marrëveshje, Koncesionari nuk mundet të transferojë, pjesërisht apo tërësisht, apo të vendosë barrë, peng, hipotekë, mbi të gjithë apo një pjesë të objekteve të koncesionit, ekzistuese apo të krijuara,



dhe/ose të gjitha apo një pjesë të të drejtave dhe detyrimit e tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe/ose kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari ka të drejtë që pas marrjes së miratimit me shkrim të Autoritetit Kontraktues dhe nëse kjo kërkohet nga financuesit e projektit dhe vetëm për qëllim të financimit të projektit, të vendosë barrë mbi objektet e koncesionit, përfshi dhe kuotat/aksionet e shoqërisë koncesionare, të vendosë hipotekë mbi asetet ekzistuese që përbëjnë objektin e koncesionit apo ato të krijuara, apo të transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat apo/dhe interesat e tij në lidhje me projektin, me qëllim vendosjen e garancive në favor të financuesve të projektit.

Koncesionari nuk mundet që pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, të transferojë, pjesërisht apo tërësisht, Marrëveshjen e Koncesionit te një palë e tretë. Palët bien dakord që miratimi me shkrim i Koncesionarit duhet të jepet brenda 15 ditëve kalendarike nga kërkesa e Koncesionarit, e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e palës së tretë dhe se një miratim i tillë nuk mund të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të paarsyeshme. Për hir të sqarimit, do të konsiderohet se refuzimi është i paarsyeshëm nëse pala e tretë së cilës propozohet t'i transferohet Marrëveshja e Koncesionit, ka të paktën të njëjtat karakteristika teknike dhe/ose financiare me Koncesionarin. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në çdo moment. Gjatë kësaj kohe afatet konsiderohen të pezulluara. Nëse Autoriteti Kontraktues dështon të japë një përgjigje për kërkesën brenda afatit 15-ditor, atëherë Palët bien dakord se kërkesa do të konsiderohet e miratuar në heshtje nga ana e tij (Autoritetit Kontraktues).

Neni 11

Amendimet dhe ndryshimet

Në nenin 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit të fundit të këtij neni shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Marrëveshja e Koncesionit dhe asnjë prej neneve të saj, nuk mund të ndryshohet, hiqet dorë, amendohet, përveçse kur ka një marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit. Një marrëveshje e tillë bëhet

efektive: a) me miratimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rastet kur parashikohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga nenet 8, 10, neni 11, neni 16 dhe neni 17, të Marrëveshjes së Koncesionit; b) me miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kur parashikohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga nenet 5 dhe 6 të Marrëveshjes së Koncesionit; dhe c) në të gjitha rastet e tjera, përfshirë dhe anekset e Marrëveshjes së Koncesionit me firmosjen e saj nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 12

Veçueshmëria

Pas nenit 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Veçueshmëria

Nëse ndonjë kusht apo nen i kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes së Koncesionit në tërësi, rezulton apo shpallet i pavlefshëm, i paligjshëm, i pazbatueshëm, nenet dhe kushtet e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes së Koncesionit në tërësi, mbeten të pacenuara.”.

Neni 13

Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në dy kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo Marrëveshje është marrëveshja përfundimtare dhe ekskluzive midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe tejkalon çdo negociatë apo marrëveshje me shkrim apo verbale ndërmjet Palëve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje, hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj dhe hyrjes në fuqi të ligjit që do ta miratojë atë.

Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Z. Damian Gjikhuri

Për shoqërinë ACR Holding s.r.l.

Z. Eglant Pupa



ANEKSI 2
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT - PLANI I INVESTIMEVE

A. Planifikimi dhe realizimi i investimeve (USD)

Objektet për t'u investuar - koncesioni fillestar	Investimet sipas Marrëveshjes Koncesionare	Realizimi deri më 31.12.2012	Realizimi nga koncesionari i ri, në periudhën 1.1.2013 - 31.6.2015	Realizimi total deri më 31.6.2015 E=(D+F)	Investime për të plotësuar shifrat e parashikuara në Marrëveshjen Koncesionare	Investime në vlerë për të plotësuar zërat e parashikuar në natyrë në Marrëveshjen Koncesionare	Investime të planifikuara mbi vlerat e parashikuara në Marrëveshjen Koncesionare	Investimi në total, sipas Marrëveshjes së Amenduar
	(C)	(D)	(F)	(E)	(G = C-E)	(H)	(I)	(J = H + I)
Miniera e Kromit Bulqizë	\$11,500,000	\$ 11,643,333	\$ 9,894,738	\$ 21,538,071	\$ (10,038,071)	5,563,000	\$23,389,718	\$28,952,718
UFK Burrel	\$ 7,200,000	\$ 1,385,203	\$ 658,036	\$ 2,043,239	\$ 5,156,761	5,814,797	\$0	\$5,814,797
FPK Bulqizë	\$ 1,800,000	\$ 3,824,189	\$ 230,643	\$ 4,054,832	\$ (2,254,832)	\$0	\$0	\$0
Imp. Seleks. Klos	\$ 100,000	\$ 524,427	\$ 725,761	\$ 1,250,188	\$ (1,150,188)	\$0	\$0	\$0
Shuma	\$ 20,600,000	\$ 17,377,152	\$ 11,509,178	\$ 28,886,330	\$ (8,286,330)	11,377,797	\$23,389,718	\$34,767,515

B. Plani i ri i investimeve sipas zërave dhe viteve (USD)

Plan i investimeve	Sasia e investimit	Realizuar 1.1.2013 - 30.6.2015	Mbetur për t'u investuar	Faza 1			Faza 2			Faza 3	
				Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI	Viti VII	Viti VIII
MINIERA E KROMIT BULQIZË	28,952,718.00	9,894,974.00	19,057,744.00	4,485,185.00	2,690,963.00	2,326,317.00	4,103,708.00	2,961,811.00	1,250,000.00	739,760.00	500,000.00
(pjesa veriore)	21,732,718	9,279,002	12,453,716	4,105,185	2,490,963	2,126,317	1,651,251	580,000	500,000	500,000	500,000
1 Investime për hapjen e traverbankut të Klosit dhe infrastrukturës përkatëse	3,482,718	451,467	3,031,251	800,000	800,000	800,000	631,251				
2 Investime për punime kapitale (P9-Niv 5-21) dhe anekset	9,600,000	6,019,037	3,580,963	2,980,000	600,963						
3 Investime makineri e pajisje	2,500,000	913,683	1,586,317	100,000	500,000	686,317	300,000				
4 Investime për punime kapitale në nivele	4,400,000	1,458,343	2,941,657	141,657	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000



5	Investime për ajrimin	400,000	227,589	172,411	32,411	40,000	40,000	30,000	30,000			
6	Investime të tjera (remonte kapitale pusesht etj.)	550,000	204,908	345,092	45,092	100,000	100,000	50,000	50,000			
7	Investimet përpunime gjeologo-zbuluese	800,000	3,975	796,025	6,025	50,000	100,000	240,000	100,000	100,000	100000	100000
	(Sektori Qafë e Buallit)	7,220,000	615,972	6,604,028	380,000	200,000	200,000	2,452,457	2,381,811	750,000	239,760	-
8	Për punime kapitale rikonstruk-sione etj.	2,500,000	260,240	2,239,760				400,000	1,500,000	300,000	39,760	
9	Ndërtim, montime e sisteme	430,000	116,804	313,196				200,000	113,196			
10	Makineri e pajisje mekanike	2,410,000	207,543	2,202,457				1,202,457	400,000	400,000	200000	
11	Makineri e pajisje elektrike	750,000	31,385	718,615				400,000	318,615			
12	Të paparashikuara	150,000	-	150,000				50,000	50,000	50,000		
13	Investime për punime gjeologjike	980,000	-	980,000	380,000	200,000	200,000	200,000				
	UZINA E FERROKROMIT BURREL	5,814,797.00	658,036.00	5,156,761.00	300,000.00	2,100,000.00	2,200,000.00	556,761.00	-	-	-	-
14	Rikonstrukcion i furrës ekzistuese	658,036	658,036	-								
15	Ndërtimi i një furre të re dhe infrastruktura ndihmëse	5,156,761	-	5,156,761	300,000	2,100,000	2,200,000	556,761				
	INVESTIME TOTAL	34,767,515	10,553,010	24,214,505	4,785,185	4,790,963	4,526,317	4,660,469	2,961,811	1,250,000	739,760	500,000

Shënim.

1. Ky aneks do të zëvendësojë aneksin 2 (“Plani i investimeve”) dhe 3 (“Cash Flow”) të Marrëveshjes së Koncesionit.

2. Palët njohin dhe pranojnë se investimet në sektorin e Qafë-Buallit do të bëhen vetëm nëse pas përfundimit të fazës së parë të projektit të shpimeve gjeologjike (zëri 13), rezulton se rezervat e nxjerrshme të mineralit të kromit vërtetohen të jenë të paktën 603,000 tonë krom të cilësisë mesatare mbi 36% Cr₂O₃.

3. Viti 1 konsiderohet periudha 1 korrik 2015–deri 30.12.2016.

4. Shembulli i përlogaritjes së investimeve dhe shumës së penaltetit: Thjesht për efekt qartësimi të formulës së përdorur në nenin nr. 3.2 të Marrëveshjes së Koncesionit, llogarisim se investimi i parashikuar për secilën fazë investimesh është parashikuar 10 milionë euro. Në fazën e parë të investimeve, Koncesionari investon 9 milionë euro. Në fund të fazës së parë të investimeve, Koncesionari do të paguajë shumën e penaltetit prej 100,000 mijë eurosh (10% x investimin e munguar (10 milionë - 9 milionë = 1 milion). Në fazën e dytë të investimeve, Koncesionari investon 12 milionë euro. 2 milionë euro të investuara më tepër se investimi i parashikuar për fazën e dytë të investimeve, do të mbarten në fazën e tretë të investimeve. Në fazën e tretë të investimeve, Koncesionari do të investojë 8 milionë euro, të cilat, së bashku me 2 milionë eurot e investuara dhe të mbartura nga faza e dytë e investimeve, përbushin detyrimin për investim në fazën e tretë të investimeve.



LIGJ
Nr. 80/2016

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT
NDËRMJET MINISTRISË SË
ENERGJISË DHE INDUSTRISË, SI
AUTORITET KONTRAKTUES, DHE
ACR HOLDING, S.R.L., SI
KONCESIONARI, PËR NDËRTIMIN,
OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E
UZINËS SË FERROKROMIT NË
ELBASAN DHE PËR MINIERAT E
KROMIT TË PËRRENJASIT E POJSKËS**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe ACR Holding, s.r.l., si koncesionari, për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Uzinës së Ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Përrenjasit e Pojskës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9713, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**SHITESË E MARRËVESHJES SË
KONCESIONIT**

**NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË
DHE INDUSTRISË, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE ACR HOLDING
S.R.L., SI KONCESIONARI, PËR
NDËRTIMIN, OPERIMIN DHE
TRANSFERIMIN E UZINËS SË
FERROKROMIT NË ELBASAN DHE PËR
MINIERAT E KROMIT, TË PËRRENJASIT
E POJSKËS**

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Koncesionit (Marrëveshja) është nënshkruar në datën 26.5.2016, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), me adresë në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si “Autoriteti Kontraktues”), përfaqësuar nga z. Damian Gjoknuri, ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe ACR Holding s.r.l., një shoqëri e së drejtës italiane me seli të shoqërisë në Milano, Itali, përfaqësuar nga z. Eglant Pupa, administrator i ACR Holding s.r.l. (këtu e më poshtë referuar si “Koncesionari”). Secili prej Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit do të quhen individualisht “Pala” dhe bashkërisht “Palët”,

meqenëse:

A. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë pasi ka shqyrtuar propozimin e paraqitur nga “Darfo” s.p.a., ka miratuar vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 8.11.1999, duke i dhënë shoqërisë “Darfo” s.p.a. koncesionin e formës BOT për minierat e Përrenjasit dhe të Pojskës dhe për Stabilimentin e Ferrokromit Elbasan;

B. Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe “Darfo” s.p.a., është firmosur një marrëveshje koncesioni e formës BOT (Marrëveshja e Koncesionit), e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8590, datë 23.3.2000, “Për miratimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” për Uzinën e Ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Përrenjasit e të Pojskës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane “Darfo” s.p.a. dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje”;



C. Në vitin 2005, kompania “Darfo” s.p.a. u shndërrua nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Darfo” s.r.l.;

Ç. Në vitin 2010, “Darfo” s.r.l. ndryshoi emërtimin në ACR Holding s.r.l.;

D. Në vitin 2013, Balfin Group bleu 100% të kuotave të shoqërisë ACR Holding s.r.l. si mbajtëse e të drejtave dhe detyrimeve të Marrëveshjes së Koncesionit;

Dh. Ministria e Energjisë dhe Industrisë është ministria përgjegjëse për mbikëqyrjen e sektorit minerar dhe Autoritet Kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

E. Koncesionari ka përfunduar investimin e tij në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit;

Ë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e ka shpallur si sektor të rëndësishëm sektorin minerar dhe kërkon që të vitalizojë investimet në këtë sektor;

F. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari kanë rënë dakord për zgjatjen e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT (Marrëveshja e Koncesionit në Bulqizë) nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe “Darfo” s.p.a., në datën 14.4.2001, e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8791, datë 10.5.2001, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT të minierës së kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë të së drejtës italiane “Darfo” s.p.a., si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje”;

G. Palët njohin dhe pranojnë faktin se ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis Marrëveshjes së Koncesionit në Bulqizë dhe kësaj Marrëveshjeje Koncesioni, për shkak të objektit dhe lidhjes funksionale midis tyre, duke qenë që kemi të bëjmë me një shoqëri koncesionare që vepron si biznes i integruar me të gjitha objektet koncesionare, duke qenë se konkretisht minerali i nxjerrë në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit në Bulqizë, përpunohet më tej në Elbasan konform kësaj Marrëveshjeje Koncesioni;

Gj. Palët njohin dhe pranojnë faktin se duke marrë në konsideratë planin e investimeve të Koncesionarit, është vendosur edhe zgjatja e periudhës së Marrëveshjes së Koncesionit në Bulqizë, si dhe investimet e reja në Uzinën e Ferrokromit Elbasan, të shprehura në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

H. Në këtë plan investimesh është marrë në konsideratë, ndër të tjera, edhe kostoja e përpunimit të mineralit në Elbasan, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje Koncesioni dhe, meqenëse kjo kosto do të ndryshonte ndjeshëm në rast se minerali nuk do të vijonte të përpunohej në këtë uzinë, zgjatja e periudhës së Marrëveshjes së Koncesionit në Bulqizë bën të domosdoshme që bashkëpunimi mes Palëve të marrë në konsideratë këto ndryshime dhe ato të reflektohen, gjithashtu, edhe në këtë Marrëveshjeje Koncesioni, duke i zgjatur afatin kësaj të fundit;

I. Palët njohin dhe pranojnë faktin që për një shfrytëzim optimal dhe eficient të burimeve minerale të dhëna në koncesion, është i nevojshëm përditësimi dhe zgjatja e periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së Koncesionit;

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Interpretimi

Përveç se kur ndryshohen shprehimisht nga kjo Marrëveshje, dispozitat e Marrëveshjes së Koncesionit do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë dhe detyruese për Palët.

Kjo Marrëveshje bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit dhe kudo ku përdoret termi “Marrëveshje Koncesioni” do të konsiderohet se ky term përfshin edhe këtë Marrëveshje.

Neni 2

Kriteret specifike të punimeve

Neni 3.1 i Marrëveshjes së Koncesionit (Kriteret specifike të punimeve), ndryshohet si më poshtë vijon:

A. Në Uzinën e Ferrokromit Elbasan do të realizohen këto investime:

1. Blerja dhe instalimi i 2 transformatorëve të furrave me fuqi 12.5 MVA.

2. Rehabilitimi i linjës së briketit të mineralit.



3. Investime të tjera, makineri e pajisje, linja teknologjike etj.

Në total, brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në Uzinën e Ferrokromit Elbasan, parashikohet të investohen rreth 1,020,000 euro, sipas specifikimeve, kushteve dhe shpërndarjes së dhënë në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3.2 i Kontratës së Koncesionit, ndryshon si më poshtë:

Koncesionari do të marrë masat që të vërë në zbatim/implementojë brenda periudhës së pritshme prej 4 vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje (Periudha e investimeve), shumën e investimeve të përshkruara në planin e ri të investimeve, duke marrë parasysh tregun dhe kushtet tregtare në Shqipëri apo në tregjet ndërkombëtare.

Nëse Koncesionari ka bërë më shumë investime se sa është parashikuar në aneksin 2 për një fazë investimi dhe këto investime janë konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë teprica e këtij investimi do t'i llogaritet si investim i bërë në fazën pasardhëse. Nëse Koncesionari ka bërë më pak investime se sa është parashikuar në aneksin 2 për një fazë investimi dhe kjo është e konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues si kusht penal vlerësues, një shumë (e referuar më poshtë si një "shumë penaliteti") që llogaritet duke aplikuar përqindjen përkatëse të përcaktuar më poshtë, mbi totalin e miratuar të investimeve për fazën e investimit përkatëse minus çdo shumë të investuar konkretisht nga ana e Koncesionarit (dhe të konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore) për atë fazë. Diferenca ndërmjet totalit të miratuar të investimeve për një fazë investimesh dhe investimeve aktuale për atë fazë do të referohet si investimi i munguar. Shuma e penalitetit do të jetë e barabartë me 10% të investimit të munguar.

Çdo shumë penaliteti do të paguhet nga Koncesionari, Autoritetit Kontraktues në përfundim të çdo faze investimesh brenda 2 (dy) muajve nga kërkesa me shkrim që i dorëzohet Koncesionarit për këtë qëllim duke përfshirë dhe një detajim të hollësishëm për llogaritjen, sipas

raportit të progresit në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Nëse pagesa nuk ndodh brenda periudhës 2-mujore sipas paragrafit më sipër, Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një kamatëvonesë, të barabartë me kamatëvonesën ligjore të përcaktuar sipas legjislacionit shqiptar.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse investimet e planifikuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje nuk janë kryer në kohë për shkak të forcës madhore dhe për sa kohë zgjat efekti i kësaj force madhore apo për shkak të një mospërmbushjeje të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari nuk do të jetë i detyruar të paguajë asnjë shumë penaliteti ndaj Autoritetit Kontraktues.

Për shmangien e çdo dyshimi, pagesa e shumës së penalitetit për çdo fazë investimesh përfaqëson shpërblimin e dëmit dhe detyrimin e vetëm që ka Koncesionari ndaj Autoritetit Kontraktues për mospërmbushjen e detyrimit të tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit në lidhje me mospërmbushjen e tij për kryerjen e investimeve.

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje në lidhje me përcaktimin e shumës së penalitetit dhe/ose pagesën e saj do të zgjidhet sipas nenit 21 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Neni 3

Detyrimet e Koncesionarit

Në nenin 5 të Marrëveshjes së Koncesionit, paragrafi 5.3 ndryshon si më poshtë:

"5.3 Të respektojë të drejtën e Autoritetit Kontraktor për ruajtjen e pronësisë të mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncesion, për sa kohë ato nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi apo bërë të pamundura për t'u rikuperuar, nga Koncesionari.

Pavarësisht kësaj, Koncesionari ka detyrimin për të dorëzuar në gjendje pune dhe në pronësi të Autoritetit Kontraktues, çdo mjet kryesor (inventarit) të marrë në koncesion që Koncesionari ka zëvendësuar, rehabilituar, përmirësuar gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Koncesionit, duke pasur parasysh, gjithashtu, amortizimin që këto mjete kanë pësuar që nga koha e zëvendësimit, rehabilitimit apo përmirësimit.



Koncensionari në rastin e zëvendësimit, rehabilitimit, rikuperimit, nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncesion, njofton Autoritetin Kontraktues.

Koncensionari me miratim të Autoritetit Kontraktues, mund t'i transferojë pjesë nga mjetet kryesore (inventarit) të marra në koncesion dhe që nuk i shërbejnë më qëllimit të koncesionit, një personi të tretë publik, duke respektuar procedurat ligjore që kërkon Autoriteti Kontraktues, si dhe duke e shoqëruar këtë transferim me dokumentacionin përkatës ligjor.”.

Neni 4

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Në nenin 6 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit “e” shtohen paragrafët “f”, “g” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“f) Autoriteti Kontraktues, brenda kompetencave të tij ligjore, do të pajisë Koncensionarin me të gjitha lejet, licencat, autorizimet dhe me çdo akt tjetër, në përgjegjësi të tij, të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare dhe do të bëjë në kohë ripërtëritjen, zëvendësimin, zgjatjen e lejeve, licencave apo autorizimeve që ekzistojnë në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Koncensionari të ketë dorëzuar në kohë dhe konform legjislacionit shqiptar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar. Autoritetit Kontraktues nuk do të shfuqizojë, revokojë apo bëjë të pavlefshëm këto leje, autorizime apo licenca gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare apo të vendosë detyrime të tjera shtesë ndaj Koncensionarit për marrjen, zgjatjen, ripërtëritjen, vlefshmërinë e këtyre lejeve, licencave, autorizimeve apo çdo akt/veprim tjetër, si kusht për të kryer njërën, disa apo të gjitha nga veprimet/aktet e përmendura në këtë paragraf, me kusht që Koncensionari të ketë respektuar kërkesat që ka legjislacioni shqiptar për këto leje, licenca, autorizime.

g) Autoriteti Kontraktues do të asistojë në institucionet përgjegjëse Koncensionarin, për pajisjen me çdo leje, licencë, autorizim tjetër të nevojshme për aktivitetin koncesionar gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

h) Autoriteti Kontraktues, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Marrëveshjen e Koncesionit, do të mbajë të padëmtuar Koncensionarin nga çdo pasojë që i vjen këtij të fundit nga dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përgjithësi nga dështimi i tij për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij të shprehura në Marrëveshjen e Koncesionit, këtë Marrëveshje dhe/ose detyrimet e tij sipas legjislacionit.”.

Neni 5

Periudha e koncesionit

Neni 8.1 i Marrëveshjes së Koncesionit ndryshon si më poshtë:

“8.1 Periudha e koncesionit përfundon më 31 dhjetor 2040.”.

Neni 8.2, shfuqizohet.

Neni 6

Mbështetja për Projektin

Neni 10 i Marrëveshjes së Koncesionit, “Mbështetja për Projektin”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Autoriteti Kontraktor bëhet garant që TVSH-ja do të rimbursohet rregullisht, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së nga ana e shoqërisë koncesionare.”.

Neni 7

Transferimi dhe garancitë

Me përjashtim kur është parashikuar ndryshe në Marrëveshjen e Koncesionit apo/dhe në këtë Marrëveshje, Koncensionari nuk mundet të transferojë pjesërisht apo tërësisht, apo të vendosë barrë, peng, hipotekë, mbi të gjithë apo një pjesë të objekteve të Koncesionit, ekzistuese apo të krijuara, dhe/ose të gjitha apo një pjesë të të drejtave dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe/ose kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

Koncensionari ka të drejtë që pas marrjes së miratimit me shkrim të Autoritetit Kontraktues dhe nëse kjo kërkohet nga financuesit e Projektit dhe vetëm për qëllim të financimit të Projektit, të vendosë barrë mbi objektet e Koncesionit, përfshi dhe kuotat/aksionet e shoqërisë



koncesionare, të vendosë hipotekë mbi asetet ekzistuese që përbëjnë objektin e Koncesionit apo ato të krijuara apo të transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat, apo/dhe interesat e tij në lidhje me Projektin, me qëllim vendosjen e garancive në favor të financuesve të Projektit.

Koncesionari nuk mundet që pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, të transferojë pjesërisht apo tërësisht Marrëveshjen e Koncesionit te një palë e tretë. Palët bien dakord që miratimi me shkrim i Koncesionarit duhet të jepet brenda 15 ditëve kalendarike nga kërkesa e Koncesionarit e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e palës së tretë dhe se një miratim i tillë nuk mund të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të paarsyeshme. Për hir të sqarimit, do të konsiderohet se refuzimi është i paarsyeshëm nëse pala e tretë së cilës i propozohet t'i transferohet Marrëveshja e Koncesionit, ka të paktën të njëjtat karakteristika teknike dhe/ose financiare me Koncesionarin. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në çdo moment. Gjatë kësaj kohe afatet konsiderohen të pezulluara. Nëse Autoriteti Kontraktues dështon të japë një përgjigje për kërkesën brenda afatit 15-ditor, atëherë Palët bien dakord se kërkesa do të konsiderohet e miratuar në heshtje nga ana e tij (Autoritetit Kontraktues).

Neni 8

Amendimet dhe ndryshimet

Në nenin 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit të fundit të këtij neni, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Marrëveshja e Koncesionit dhe asnjë prej neneve të saj, nuk mund të ndryshohet, hiqet dorë, amendohet, përveçse kur ka një marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit. Një marrëveshje e tillë bëhet efektive: a) me miratimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rastet kur parashikohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga neni 8, 10, neni 11, neni 16 dhe neni 17 të Marrëveshjes së Koncesionit; b) me miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kur parashikohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga nenet 5 dhe 6 të Marrëveshjes së Koncesionit; dhe në të gjitha

rastet e tjera, përfshirë dhe anekset e Marrëveshjes së Koncesionit; c) me firmosjen e saj nga Autoriteti Kontraktues.”.

Neni 9

Veçueshmëria

Pas nenit 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Veçueshmëria

Nëse ndonjë kusht apo nen i kësaj Marrëveshjeje në tërësi, rezulton apo shpallet i pavlefshëm, i paligjshëm, i pazbatueshëm, nenet dhe kushtet e tjera të kësaj Marrëveshjeje në tërësi, mbeten të pacenuara.”.

Neni 10

Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në dy kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo Marrëveshje është marrëveshja përfundimtare dhe ekskluzive midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe tejkalon çdo negociatë apo marrëveshje me shkrim apo verbale ndërmjet Palëve.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje, hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj dhe hyrjes në fuqi të ligjit që do ta miratojë atë.

Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Z. Damian Gjijnuri

Për shoqërinë ACR Holding s.r.l.

Z. Eglant Pupa



ANEKSI 2
MARRËVESHJA E KONCESIONIT - PLANI I INVESTIMEVE

**B. Plani i ri i investimeve sipas zërave dhe viteve
(euro)**

	Plan i investimeve	Sasia e investimit	Faza 1		Faza 2	
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV
	Uzina e Ferrokromit Elbasan	1,020,000.00	350,000.00	570,000.00	50,000.00	50,000.00
1	<i>Blerja dhe instalimi i 2 transformatorëve të furrave me fuqi 12.5 MVA</i>	720,000	200,000	520,000		
2	<i>Rehabilitimi i linjës së braketimit të mineralit</i>	150,000	150,000			
3	<i>Investime të tjera makineri e pajisje, linja teknologjike etj.</i>	150,000		50,000	50,000	50,000

Shënim:

1. Ky aneks do të zëvendësojë aneksin 2 (“Plani i investimeve”) dhe 3 (“Cash Flow”) të Marrëveshjes së Koncesionit.
3. Viti 1 konsiderohet periudha 1 korrik 2015 – deri 30.12.2016.

**LIGJ
Nr. 81/2016**

**PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË
PALUAJTSHME**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

**Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për
individët**

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 28 shkurt 2017, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Në rast se individë zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.

4. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme përllëgarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së pasqyruar në akt ekspertimi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet minimale fiskale, dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi;

b) tatimin që duhet të paguajë individë për ta regjistruar këtë rivlerësim.

5. Në rast se individë zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me çmimet minimale fiskale në fuqi, atëherë ky fakt shprehet në formularin që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme përllëgarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi;

b) tatimin që duhet të paguajë individë për ta regjistruar këtë rivlerësim.

7. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.



8. Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 2% e bazës së tatueshme, që përcaktohet sipas pikave 4 dhe 6 të këtij neni.

9. Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës, në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi.

Neni 2

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për personat juridikë

1. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive.

2. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga ekspertë të pavarur, të licencuar për vlerësimin e pasurisë nga institucionet përkatëse.

3. Diferenca nga vlera kontabël, e regjistruar në pasqyrat financiare, me vlerën që rezulton nga rivlerësimi, pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2016.

4. Personat juridikë, për këtë rivlerësim, paguajnë 3 % të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për pasuritë e paluajtshme. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivitetit dhe tatimin përkatës, të paguar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi

Subjekt i këtij ligji është edhe rivlerësimi i pasurive të paluajtshme të individëve dhe personave juridikë, të cilët janë në proces regjistrimi.

Neni 4

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët për procedurat e zbatimit të këtij ligji brenda 15 ditëve nga dekretimi i tij nga

Presidenti i Republikës. Në këtë udhëzim përcaktohet edhe tarifa e kryerjes së këtij shërbimi nga ZRPP-ja.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 28 shkurt 2017.

Miraturar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9714, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 83/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT GLOBAL KUNDËR SIDA-s, TUBERKULOZIT DHE MALARIES

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malariae, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9715, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



MARRËVESHJA KUADËR
NDËRMJET FONDIT GLOBAL PËR
LUFTËN KUNDËR SIDA-s,
TUBERKULOZIT DHE MALARIES DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kjo Marrëveshje Kuadër (Marrëveshja Kuadër), datë _____ (data e hyrjes në fuqi), është lidhur nga dhe ndërmjet Fondit Global kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malaries (Fondi Global) dhe Republikës së Shqipërisë (Marrësi i Fondit) (Fondi Global dhe Marrësi i Grantit, më poshtë të referuar bashkërisht si “Palët” dhe individualisht si “Pala”),

duke pasur parasysh se Fondi Global është krijuar në janar të vitit 2002 si një institucion financimi inovativ, me qëllim tërheqjen dhe menaxhimin e burimeve financiare në nivel global, si dhe sigurimin e këtyre burimeve për vendet, për të mbështetur programe kombëtare dhe rajonale, të cilat parandalojnë, trajtojnë dhe kujdesen për njerëzit me sëmundjen e HIV/SIDA, tuberkulozit dhe/ose malaries; dhe

duke pasur parasysh se subjekte të caktuara të Marrësit të Grantit kanë qenë ose janë/pritet të caktohen nga vendi përkatës apo mekanizmi/at koordinues rajonal/ë, për të zbatuar programin/et përkatës/e (siç përcaktohet në rregulloret për grantin e Fondit Global (2014)), në vendin pritës përkatës (siç përcaktohet në rregulloret për grantin e Fondit Global (2014)) apo vendet pritëse;

tani dhe në vijim, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

**Rregulloret për grantin e Fondit Global
(2014)**

1.1 Përfshirja me referencë. Të gjitha dispozitat e rregulloreve për grantin e Fondit Global (2014), janë bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje Kuadër, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin të përcaktuara plotësisht në të.

1.2 Termat e përcaktuar. Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje Kuadër, termat e përcaktuar në rregulloret për grantin e Fondit Global (2014) do të kenë kuptimet përkatëse të përcaktuara në këtë dokument, përveç nëse ndryshohen këtu ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

Neni 2

Konfirmimi i granteve

2.1 Konfirmimi i grantit

1. Fondi Global dhe Marrësi i grantit parashikojnë të lidhin një ose më shumë konfirmime granti për zbatimin e programit/eve të caktuar/a në vendin pritës përkatës apo vendet pritëse, me të dhënat përkatëse të përcaktuara në secilën prej këtyre konfirmimeve të grantit.

2. Sipas një konfirmimi të tillë granti, në qoftë se lidhet dhe në pajtim me dispozitat e neneve 3.2 dhe 3.3 të rregulloreve për grantin e Fondit Global (2014), Fondi Global do të konfirmojë gatishmërinë e tij për të vendosur në dispozicion të Marrësit të grantit, me qëllimin e vetëm të programit dhe për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit, fonde të caktuara granti, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në një konfirmim të tillë granti.

3. Sipas secilit konfirmim granti, nëse lidhet, Marrësi i grantit do të konfirmojë gatishmërinë e tij për zbatimin e veprimtarive përkatëse të programit, duke përdorur fondet e grantit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në një konfirmim të tillë granti.

2.2 Asnjë mbështetje apo detyrim. Me lidhjen e kësaj Marrëveshjeje Kuadër, Fondi Global nuk është i detyruar të përgatisë, lëshojë apo zbatojë ndonjë konfirmim granti përveç nëse, në diskrecionin e tij të vetëm, vendos për ta bërë këtë dhe Fondi Global nuk është përgjegjës për ndonjë dëmtim, humbje, kosto apo detyrim që marrësi i grantit apo ndonjë prej marrësve të tij kryesorë, nën-marrësve apo furnizuesve aktualisht apo mund të vuajnë ose të pësojnë pasi Fondi Global nuk përgatit, lëshon apo zbaton një ose më shumë apo ndonjë konfirmim të veçantë granti, sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

Neni 3

Interpretimi

3.1 Mospërputhja. Secili dhe çdo konfirmim granti është subjekt i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Kuadër. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të konfirmimit të grantit për një program dhe një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje Kuadër, sigurimi i konfirmimit të grantit do të mbizotërojë me qëllim të (por vetëm në masën e) këtij programi.



3.2 Marrëveshja e vetme. Të gjitha konfirmimet e grantit janë bërë në mbështetje të mirëkuptimit të Palëve se kjo Marrëveshje Kuadër së bashku me të gjitha konfirmimet e grantit (duke përfshirë çdo dhe të gjitha ndryshimet e mëvonshme të saj) formojnë një marrëveshje të vetme ndërmjet Palëve.

Neni 4 Të tjera

4.1 Mbijetesa

1. Për çdo program, të gjitha marrëveshjet, përfaqësimet dhe angazhimet e bëra nga Marrësi i grantit (dhe nëse ka, nga ana e përfituesit kryesor përkatës) në Marrëveshjen e Grantit do të konsiderohet se është mbështetur nga Fondi Global dhe do të vazhdojë edhe pas ekzekutimit dhe dorëzimit të Marrëveshjes së Grantit, pavarësisht ndonjë investigimi apo vlerësimi të bërë nga Fondi Global apo nga ndonjë palë tjetër e tretë në emër të tij, para ekzekutimit dhe dorëzimit të Marrëveshjes së Grantit apo pavarësisht se Fondi Global mund të ketë pasur njoftim ose informacion mbi ndonjë fakt apo përfaqësim apo garanci të pasaktë, në çdo kohë gjatë periudhës së zbatimit dhe do të vazhdojë në fuqi dhe efekt të plotë deri në fund të kësaj periudhe zbatimi.

2. Për secilin program, paragrafët 1.1, 1.2, 2.2, 3.1, 3.2 dhe 4.1 deri 4.3 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër dhe paragrafët 1.3, 2.1 deri në 2.4, 3.1, 3.3(3), 3.4 deri në 3.6, 4.2, 4.3(4), 4.4(2), 5.2, 6.4(2), 6.5, 6.6, 7.1, 7.5, 7.6, 10.3, 10.4 dhe nenet 11 dhe 12 të rregulloreve për grantin e Fondit Global (2014) do të vazhdojnë edhe pas skadimit të afatit të periudhës së zbatimit apo përfundimit para kohe të Marrëveshjes së Grantit.

3. Për çdo program, skadimi i periudhës së zbatimit apo ndonjë ndërprerje para kohe e Marrëveshjes së Grantit, për çfarëdolloj arsyeje, nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet të cilat i shkaktohen apo ekzistojnë për secilën Palë para këtij skadimi apo përfundimi të parakohshëm.

4.2 Ligji zbatues. Për çdo program, marrëveshja përkatëse e grantit do të rregullohet nga parimet e UNIDROIT të Kontratave Ndërkombëtare Tregtare (2004).

4.3 Njoftimet

1. Çdo njoftim sipas Marrëveshjes Kuadër apo çdo konfirmim granti që Palët i japin njëra-

tjetrës (Njoftimi) duhet të bëhet me shkrim dhe dorëzohet personalisht ose apo me postë të certifikuar apo të regjistruar (postim me parapagim), me postë ndërkombëtare, me faks apo nëpërmjet sistemit të mesazheve elektronike, në adresën përkatëse dhe/ose numrin e përcaktuar më poshtë apo në ndonjë adresë (a) dhe/ose numër (a) tjetër, ku secila Palë mund t'i drejtohet Palës tjetër me një njoftim me shkrim, në përputhje me këtë paragraf:

a) nëse bëhet fjalë për një çështje në lidhje me një program specifik, në adresën dhe/ose numrin përkatës të përcaktuar në konfirmimin përkatës të grantit; dhe

b) nëse bëhet fjalë për një çështje në lidhje me këtë Marrëveshje Kuadër, në përgjithësi apo që ka ndikim të mundshëm në më shumë se një program sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër, në adresën dhe/ose numrin përkatës të përcaktuar më poshtë ose në një adresë (a) dhe/ose numër tjetër (a), ku secila Palë mund t'i drejtohet Palës tjetër me një njoftim me shkrim, në përputhje me këtë paragraf:

Për Fondin Global:

Fondi Global kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malarisë

Chemin de Blandonnet 8, 1214 Vernier, Geneva, Switzerland
Në vëmendje

të: Mark Eldon-Edington
Përgjegjësi, Departamenti për Menaxhimin e Grantit
Telefon: +41587911750
Faks: +41 58 791 17 01
E- mail: headgrantmanagement@theglobalfund.org

Për Marrësin e Grantit:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

[adresa]

Në vëmendje [emri]

të:

[titulli][ministra/ departamenti]

Telefon:

Faks:

Posta

elektronike:

2. Çdo njoftim do të konsiderohet se është dhënë në mënyrë të rregullt: a) kur dorëzimi te Pala marrëse është i plotë nëse dorëzohet personalisht ose me postë ndërkombëtare; b) me konfirmim marrjeje, nëse është dorëzuar me postë të regjistruar apo të certifikuar, postim me parapagim; c) me konfirmim të transmetimit të



suksesshëm nëse dërgohet me faks; dhe d) kur dërgohet me sukses nëse bëhet përmes sistemit të mesazheve elektronike, me kusht që të shoqërohet nga transmetimi i origjinalit të këtij njoftimi, nëpërmjet postës ndërkombëtare ose me postë të regjistruar apo të certifikuar, postim me parapagesë.

3. Në rast të dërgimit të ndonjë komunikimi të Fondit Global nëpërmjet Agjentit Lokal të Fondit, siç mund të kërkohe në bazë të Marrëveshjes së Grantit, Marrësi i Grantit apo përfituesi kryesor përkatës, i cili vepron në emër të Marrësit të Grantit, duhet t'i dorëzojë një komunikim të tillë përfaqësuesit të Agjentit Lokal të Fondit, detajet e të cilit ndodhen në konfirmimin e Grantit, duke ndjekur një parim të ngjashëm me atë të përshkruar në nënparagrafin 2, të paragrafit të mësipërm.

4. Të gjitha komunikimet sipas Marrëveshjes përkatëse të Grantit do të jenë në gjuhën angleze dhe një kopje do t'i jepet Mekanizmave Koordinues të Vendit (CCM), Mekanizmave Rajonale Koordinues (RCM) apo Organizatave Rajonale (RO).

4.4 Kopjet, dorëzimi nëpërmjet faksit apo sistemit të mesazhit elektronik. Kjo Marrëveshje Kuadër dhe të gjitha konfirmimet e Grantit mund të bëhen në një ose më shumë kopje, të cilat do të përbëjnë një dhe të njëjtën

marrëveshje, sikur Palët të kishin nënshkruar të njëjtin dokument. Kjo Marrëveshje Kuadër dhe të gjitha konfirmimet e Grantit mund të nënshkruhen dhe të dorëzohen me anë të transmetimit me mesazhe elektronike dhe ky nënshkrim dhe dorëzim do të kenë të njëjtën fuqi dhe efekt si një dokument origjinal me nënshkrimet origjinale.

4.5 Data e hyrjes në fuqi. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur Pala shqiptare njofton Fondin Global mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje Kuadër nga përfaqësuesit e tyre përkatës të autorizuar, në datën e hyrjes në fuqi.

Fondi Global kundër SIDA-s Tuberkulozit dhe Malaries

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë